

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7352 E hënë 13 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Recenca **e** Ditës

Duke kërkuar të vërtetën retorike të Fan Nolit, 100 vjet pas tij nuk u dukën më aq shumë, krahasuar mijëra vjet të shqipes si të tij e për më befashëm ...  
Vijon në faqet 18-19

## Nga ENTELA KOMNINO

E vërteta për Nolin ose procesi shqip



## Opinion **i** Ditës

Një nga dobësitë e të gjitha qeverive shqiptare në fushën e diplomacisë ka qenë pazotësia ose neglizhenca për t'u bërë të qartë shteteve ....  
Vijon në faqen 21

## Nga SHABAN MURATI

Shqipëria të bllokojë Serbinë në "Frankofoni"



Secretari i PD-së: Për vjedhjen e votës kam fakte

## Enno Bozdo: Çfarë duhet të bëjë opozita para se të nisë protestat

"Aleanca me LSI-në e përcaktuar nga situata e rëndë. Për kauza madhore nuk i mbylлим derën askujt"

Nga VALENTINA MADANI

PD-ja nuk mundi ta "fotografjë" vjedhjen e votës me 25 qershor, por dokumentimin me dëshmi konkrete po e bën tani përmes procesit të analizës së humbjes dhe riorganizimit të partisë. ...  
Në faqet 4-5

## KUSHTET E PERFITIMIT DHE KATEGORITE QE PERFSHIHEN NE KETO SIGURIME

# ISSH: SI DO LLOGARITEN PENSIONET E INVALIDEVE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Ja periudhat minimale që duhet të keni siguruar për pension të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm...



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

### DEKLARATA

Investimet, Rama: Vjeshta histerike e politikës nuk na e pengon punën  
Në faqen 3

### DETAJET E REJA

"300 mln lekë për kurim", lihet në burg gjyqtari që liroi Gent Dodën  
Në faqen 6

### VENDIMI PER MALLAKASTREN

Shkarkimi i kreut të KQZ, Balla: Shkeli ligjin. Zguri: Sulm politik ndaj meje  
Në faqen 2

### HETIMET

Iu kapën 1.5 tonë drogë në Velipojë, flet vetëm një prej 7 të arrestuarve  
Në faqen 7

### STUDIMET: CELULARET RREZIK PER TUMORE



Zelija: Urgjencat diabetike, rritje e ndjeshme te të rinjët. Kurat me hithra  
Suplement

"Shkrimtarët në diktaturë", zbulohet dokumenti sekret për arrestimin e tyre.

## "Sportistët e Partizanit e Kombëtares bëjnë kontrabandë"

Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm më 1970: Kë kemi në lista...

Nga DASHNOR KALOÇI

Në izolimin e plotë ku ndodhesh Shqipëria gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës deri në vitin 1990-të, përveç atyre që dilnin jashtë shtetit për arsye pune, si diplomatët, Marina Tregtare apo Agroek-



sporti, të vetmit shtetas që u jepe mundësia që të dilnin ndonjëherë jashtë, ishin artistët dhe sportistët, të cilët me dietat minimale që u jepte shteti i asaj kohe, nuk kishin mundësi që të blinin në shtetet ku ata shkonin diçka për vete apo ...  
Në faqet 10-11

## MAXHORANCA VENDIMI

La në detyrë Kapllanaj, PS nis procedurat për largimin e kryetarit të Komisionit

# Shkarkimi i kreut të KQZ, Balla: Shkeli ligjin. Zguri: Sulm politik

"Po mbjellin frikë dhe po cenojnë shtetin ligjor"

Valentina Madani

Partia Socialiste do t'i kërkojë parlamentit shkarkimin e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Klement Zguri. Në emër të PS-së kreu i Grupit Parlamentar, Taulant Balla, kërkoj dje shkarkimin e Klement Zgurit nga detyra e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo kërkesë vjen pas debatit të javës së shkuar, ku PS kërkoj shkarkimin e kreut të Bashkisë Mallakastër, Agron Kapllanaj. Sipas Partisë Socialiste, Kapllanaj është i dënur në Itali dhe duhet që të shkarkohej, por kjo kërkesë është hedhur poshtë nga opozita që ka shumicën në KQZ. Kreu i KQZ Klement Zguri është pjesë e paktit Rama-Basha dhe është një emër që është propozuar nga opozita. "Jemi në kushtet kur është më se e qartë se Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Klement Zguri ka kryer shkelje të rënda të ligjit dhe përmes veprimeve e mosveprimeve të tij i shtyu sa mundi jetën politike një të zgjedhuri lokal me rekorde të rënda kriminale, vetëm e vetëm sepse është i të njëjtit krahu politik me të dhe i ndikuar nga urdhrat politike", theksoi Balla.



Taulant Balla



Klement Zguri

### Kreu i FRPD akuza për rrënim të shqiptarëve

## PD, Këllici: Pusi si krimi më i ri i Ramës

Kreu i FRPD-së, Belind Këllici, bën një pasqyrim të realitetit në vend, ku thekson se kryeministri dhe shteti janë të lidhur kokë e këmbë me krimin e organizuar dhe bandat. "Cilit shqiptari i duhet Saimir Tahiri, ish ministri i Brendshëm që kanabizoi Shqipërinë?! Shqipëria sot në të gjitha kancelaritë europiane etiketohet si narko-shteti, ku ligjin e bën krimi që drejton qeverinë. Cilit shqiptar i duhet mbrojtja që Edi Rama po i bën Tahirit, i cili sot duhet të ishte prapa hekurave, sepse mbi të rëndojnë akuza shumë më të rënda se një faturë dritash apo uji, më të cilat Edi Rama akuzon çdo ditë qytetarët? Cilit shqiptar i duhet mbrojtja që policia vazhdon t'i bëjë Orest Sotës, njëriut që iu gjetën të paktën 860 mijë euro të Saimir Tahirit në makinë dhe që ende nuk dihet çfarë tjetër fshihet nga ai udhëtim misterioz? Sa i përket qeverisjes, të dhënat e katër viteve që shkuan janë tejet dëshpëruese. Mbi 200 mijë shqiptarë lanë Shqipërinë e afro gjysma e atyre që mbetën, nuk sigurojnë dot bukën e fëmijëve dhe nuk paguajnë dot dritat e ujin, nuk sigurojnë dot ngrohjen. Në katër vite Edi Rama nuk bëri dot një metër rrugë. Shikoni rrugën Tiranë - Elbasan, nuk dihet nëse do të përfundojë ndonjëherë, ndërkohe që çdo ditë e më shumë po e gërryen gropa e korrupsionit e hapur nga Edi Rama. Autostrada Fier - Vlorë katër vjet asnjë metër, rruga e Pogradecit katër vjet e papërfunduar, por është kthyer në një parajsë për të mbushur xhepat e pushtetarëve me fondet e saj", shprehet Këllici.

### REAGIMI

Por në një reagim për "Neës24" kryetari i KQZ-së tha se e vërteta është e kundërta e asaj që preten-

dohet nga deputetët e PS-së në lidhje me çështjen e sipërpërmendur. Ai pretendon se po sulmohet dhe se

nuk do të përfshihet në lojëra politike. "Puna e KQZ-së, për fat të mirë, është në dritën e diellit. Nuk ka

### TAULANT BALLA

"Jemi në kushtet kur është më se e qartë se kreu i KQZ, Zguri ka kryer shkelje të rënda të ligjit dhe përmes veprimeve e mosveprimeve të tij i shtyu sa mundi jetën politike një të zgjedhuri lokal me rekorde të rënda kriminale, vetëm e vetëm sepse është i të njëjtit krahu politik me të dhe i ndikuar nga urdhrat politike", theksoi Balla.

### KLEMENT ZGURI

"Tërheq vëmendjen se sulmet ndaj KQZ-së, sidomos kur janë haptazi abuzive, në kundërshtim të plotë me ligjin dhe të motivuara nga interesa politike të palidhura me KQZ-në dhe zgjedhjet, dëmtojnë rëndë autoritetin dhe pavarësinë e KQZ-së, mbjellin frikë dhe pasiguri tek institucionet, cenojnë shtetin ligjor", theksoi Zguri.

vetëm kronika lajmesh, por ka mbledhje, procesverbale, akte dhe vendime. Të gjitha publike. Të gjitha mund të konsultohen në çdo kohë nga çdo njeri. KQZ-ja nuk fshihet. KQZ-ja vetëm zbardh. Kështu që edhe në rastin konkret, e vërteta është krejt tjetër, është e kundërta e asaj që pretendohet. Por, në respekt të funksionit zyrtar që mbuloj, unë e kam të ndaluar të përfshihem në beteja, apo lojëra politike, ndaj nuk bëhem dot pjesë e debatit. Përgjigjia ime mund të jetë vetëm zyrtare dhe vetëm drejtuar organit të emërtesës, sapo ai ta kërkojë këtë", theksoi Zguri për "News24". Kreu i KQZ-së vuri në dukje se: "Më duhet të tërheq vëmendjen publikisht: Sulmet ndaj KQZ-së, sidomos kur janë hap-



### Denoncimi për kreun e postës së Himarës

## Berisha: Si transportohet drogë nga Porto Palermo

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje në rrjetin social 'Facebook' se kreu i postës së Himarës me ish-shefin e kufirit në Dhërmi po transportojnë drogë vazhdimisht nga Porto Palermo. Një qytetar dixhital denon-

con te Berisha se nga Porto Palermo bëhet trafik drogë dhe se organizatorë sipas tij janë ish-komandanti i Postës së Himarës dhe ish-shefi i Kufirit të Dhërmiut. Madje qytetari thotë se edhe mbrëmjen e kaluar ka parë se si kryhej transporti. "Nga Porto Palermo vazhdon trafiku shtetëror i drogës! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital! Sb. "Prsh Doktor. Jam një qytetar nga Bashkia e Himarës. Dua t'ju informoj me gjendjen e trafikimit të hashashit në zonën e Porto Palermos. Sa herë që del gomonia e policisë në det dhe furgoni i policisë në qarkullim, ndodh që transportohet hashash. Këtë fenomen e kam parë shumë herë. Mund t'ju them se organizatori i këtij trafiku është ish-komandanti i Postës së Himarës, Viktori bashkë me Sokolin ish-shefi i Kufirit të Dhërmiut, të cilët kanë edhe disa policë të thjeshtë. Dua t'ju them se sontë kryhet transport, e pashë me sytë e mi. Ju lutem, në qoftë se e publikoni këtë mos më nxirni në skenë anonim, ju lutem". Thuhet në mesazhin e qytetarit dixhital.

### PREZANTIMI

Prefekti i ri i Korçës, Dhori Spirollari, i cili pason Pandi Papandon që ka mbajtur më parë këtë pozicion, u prezantua dje nga ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi. Ai u shpreh se perfekt është një përfaqësues në rang rajonal i kryeministrit dhe se institucioni i tij do të ketë rol kyç në jetësimin e reformës së ujit, të cilën e cilësoi prioritet të qeverisë.

tazi abuzive, në kundërshtim të plotë me ligjin dhe të motivuara nga interesa politike të palidhura me KQZ-në dhe zgjedhjet, dëmtojnë rëndë autoritetin dhe pavarësinë e KQZ-së, mbjellin frikë dhe pasiguri tek institucionet, cenojnë shtetin ligjor. Këto janë ankorat që mbajnë KQZ-në përballë

tallazeve. Nuk ka parti politike që njeh dhe pranon rregullat e lojës, zgjedhjet e ndershme dhe shtetin ligjor, që mund të ketë vullnetin t'i këpusë këto ankora. Ndaj unë u bëj thirrje të gjitha palëve që lojnë politike ta zhvendosin diku gjetkë, në ndonjë fushë ku interesit publik i bëjnë më pak dëm".





Kryeministri Edi Rama dhe në Burrel

"Rruga e Arbrit fillimi, program masiv transformimi për rrugët shqiptare"

# Investimet, kryeministri: Vjeshta histerike e politikës, s'na pengon

Rama: Me pallavra e shpikje duan të ndalojnë qeverinë

Kryeministri Edi Rama gjatë "Komunikimit javor" premtoi dhe investime masive dhe një program transformimi për rrugët shqiptare. Z.Rama foli për investimet urbane përtej qyteteve ndërsa njoftoi se qeveria është një hap larg nisjes së Rrugës së Arbrit, e cila sipas tij është vetëm fillimi i një projekti masiv për transformimin e rrugëve shqiptare dhe kthimin e tyre në rrugë me standarde evropiane. Në "Komunikimin javor", kryeministri Edi Rama foli për një vjeshtë histerie politike, e cila duhet lënë pas sipas tij, pasi shqiptarëve më shumë se çdo gjë iu intereson puna dhe zhvillimi. Kreu i qeverisë akuzoi kundërshtarët politikë se me "pallavrat dhe shpikjet" e tyre duan të ndalojnë çdo hap të bërë para nga qeveria e tij. "Kjo vjeshtë histerike e politikës, nuk mund të na pengojë për të bërë detyrën tonë. Ta mbajmë të plotë përgjegjësinë që na kanë dhënë njerëzit," theksoi z.Rama. "Vetëm me reformat e vështirë dhe jo me gënjeshtër, me hap të vogël, jo me iluzione e pallavra mund ta bëjmë Shqipërinë. Kujt i duhet shërrri e konfliktit? Njerëzve të zakonshëm jo njëherë. Kujt i duhet pallavrat që shpik politika çdo ditë? Shqipërisë jo njëherë. Është për të ardhur keq, kur sheh kazanin e politikës të ziejë në vorbullën e pallavrave e shpikjeve. Kjo vjeshtë histerike e politikës, nuk mund të na pengojë për të bërë detyrën tonë. Ta mbajmë të plotë përgjegjësinë që na kanë dhënë njerëzit. U deshën shumë hapa për të nisur rrugën e Arbrit, plot 4 vite për të ardhur deri këtu, ama erdhëm, po jo si të tjerët, që e kthyen rrugën e Arbrit si një nga premtimet më të përsëritura e të pa mbajtura," - u shpreh ai. I bindur për detyrën që ka, kryeministri tha se ashtu si me Rrugën e Arbrit shumë akse të tjera kombëtare do kenë standarde evropiane. "U deshën shumë hapa të vegjël për të arritur më në fund vetëm në një hap larg nga nisja e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Plot katër vjet për të ardhur këtu, ama erdhëm jo si të tjerët që u nisën e u harruan gjithnjë



Kryeministri Edi Rama

rrugës, duke e kthyer në një nga premtimet më të pa mbajtura të historisë. Ndryshimet e vërteta duan kohë, punë dhe mund", - theksoi Rama. Kryeministri nënvizoi se: "Kemi një projekt masiv për t'i kthyer rrugët kombëtare në rrugë

evropiane, me siguri e me lëvizshmëri të garantuar, me standarde të certifikuar dhe natyrisht me hijeshi ditën dhe me ndriçim siç duhet natën. Merrreni me mend që 27 vjet natën në të gjithë Shqipërisë, ndriçohet vetëm

**PROGRAMI**  
"Kemi një program masiv investimesh që ka nisur me Rrugën e Arbrit, por do të vazhdojë për t'i kthyer rrugët shqiptare në rrugë evropiane, me siguri e lëvizshmëri të garantuar, me standarde të certifikuar dhe me hijeshi ditën e ndriçim siç duhet natën. Merrreni me mend, 27 vite dhe natën ndriçohet vetëm aksi Rinas-Tiranë, sa shumë kemi ende për të bërë", - tha Rama.

aksi Rinas-Tiranë. Por duke hedhur çdo ditë nga një hap ne do bëjmë një progres të konsiderueshëm", - vijoi ai. Me buxhetin e ri, siç tha Rama, rrugët e rilindjes urbane do shkojnë deri në Theth, Kurvelesh, Lurë e Frashër.

## CHRISTIAN HELLBACH

Zyrtari i lartë gjerman vëren se në sektorët e zhvillimit të infrastrukturës, tregtisë, shkëmbimeve rinore dhe bashkëpunimit shkencor është arritur progres i rëndësishëm. "Ne jemi të gatshëm të japim më shumë mbështetje", - tha ai.



Christian Hellbach

Zyrtari i Berlinit: Gjermania krahe Ballkanit, por ndryshimin bëjeni ju!

Drejtori për Europën Jug-Lindore në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Christian Hellbach, deklaroi për "Deutsche Welle"-s se qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor presin me të drejtë një përmirësim konkret të kushteve të tyre të jetesës përmes procesit të përafritimit me Bashkimin Europian. Një ndër çështjet thelbësore të Procesit të Berlinit, sipas tij, është të ofrojë mbështetje në këtë kontekst. Intensifikimi i bashkëpunimit politik dhe atij ekonomik në rajon i ka dhënë një dinamikë të re përafritimit me bllokun dhe do të sjellë rritje të mirëqenies për popullsinë. Zyrtari i lartë gjerman vëren se në sektorët e zhvillimit të infrastrukturës, tregtisë, shkëmbimeve rinore dhe bashkëpunimit shkencor është arritur progres i rëndësishëm. Ne jemi të gatshëm të japim më shumë mbështetje, thotë ai. Ministri i Jashtëm Federal, Sigmar Gabriel, bëri të ditur në maj intensifikimin e angazhimit gjerman. Por, ne mund vetëm të mbështesim, shton Hellbach. Transformimi i shtetit, shoqërisë dhe ekonomisë, që është parakusht për përafritimin me BE-në dhe njëkohësisht edhe për më shumë mirëqenie, duhet të realizohet nga politika shqiptare. Për këtë qëllim, nevojiten reformat të qëndrueshme, të realizuara me seriozitet, ku një vlerë veçanërisht të konsiderueshme kanë konsolidimi i shtetit ligjor, qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit. Shpresat në Berlin, nga sa shpjegon Hellbach, janë që qytetarët të ndjejnë një progres konkret edhe në këto aspekte. Kriteret për çeljen e bisedimeve të anëtarësimit janë të njohura, sqaron ai. Tani është në dorën e Shqipërisë që të arrijë progresin e kërkuar në 5 prioritetet kyçe.

## Përfundon takimi dy ditor në Kretë, vendimet

# Negociatat, Bushati-Kotzias të buzëqeshur, takim në Shqipëri

Ministrat e Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe Greqisë, Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias, zhvilluan bisedime në Kretë më 10-12 nëntor 2017, duke u fokusuar në çështjet e hapura dypalëshe. Gjatë bisedimeve, të cilat u zhvilluan në një atmosferë miqësore dhe konstruktive, u krye një punë substanciale. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme njoftoi dhe sa ka përfunduar në Kretë takimi dy ditor ndërmjet ministrave të Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe Greqisë, Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias. Takimi ka përfunduar me një buzëqeshje dhe shtërngim duarshtërngim të ministrave. MPJ njofton se të dyja palët pranuan rëndësinë e dialogut në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura dhe ranë dakord për hapet e mëtejshme që duhen ndërmarrë për të arritur rezultate pozitive duke u mbështetur në vlerat dhe



Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias

## REAGIMI

Sipas deputetit të PD-së Tritan Shehu, nuk ka asgjë të re nga bisedimet mes ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, dhe homologut të tij grek Niko Kotzias në Kretë. Madje ai e krahason takimin e tyre me titullin e autorit të njohur Remarque "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit". Shehu shkruan në FB se ishte ministri i Jashtëm grek, Kotzias ai që doli i fituar nga ky takim.

normat evropiane, në të mirë të dy vendeve dhe popujve të tyre. Bisedimet përbënë një hap të rëndësishëm përpara dhe përpjekjet për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për problemet ekzistuese prej një kohe të gjatë do të vijojnë. Në ditën e këtyre zhvillimeve, u ra dakord që ministrat të takohen sërish

në Shqipëri në vijim, në mënyrë që të vlerësojnë progresin e arritur dhe të vendosin për hapet e mëtejshme konkret përpara. Dy ditë më parë z.Bushati u shpreh se është një dosje 70-vjeçar me Greqinë dhe për pasojë kërkon kohën e vet për një zgjidhje në frymën evropiane.

## ANALIZA E ZGJEDHJEVE INTERVISTA

Vjedhja e votës, sekretari i PD: Dëshmitë e identifikimit me "emër dhe mbiemër"

# Bozdo: Çfarë duhet të bëjë PD-ja para se të nisë protestat

## "Aleanca me LSI e përcaktuar nga situata e rëndë"

Valentina Madani

PD-ja nuk mundi ta "fotografojë" vjedhjen e votës me 25 qershor, por dokumentimin me dëshmi konkrete po e bën tani përmes procesit të analizës së humbjes dhe riorganizimit të partisë. Enno Bozdo sekretari organizativ i PD-së tregon për "Gazeta Shqiptare" se ka mundur të sigurojë dëshmi të identifikimit me "emër dhe mbiemër", sipas tij, të "mbjellësve të drogës, të shpërndarësve të parave në zona të caktuara, të kasnecëve monetare si dhe të atyre zyrtarëve që bënin presion me ndihmën ekonomike dhe me vendin e punës". Bozdo thotë se të gjitha këto do të dokumentohen dhe PD-ja do të marrë të gjitha hapat e nevojshme politike dhe ligjore për të trajtuar fenomenin e shitblerjes së votës. Z.Bozdo flet për ngritjen në shkallën më të lartë të aksionit politik të PD-së dhe çfarë duhet të bëjë ajo para se të nisë protestat.

**Z.Bozdo si po ecën procesi i analizës së humbjes së PD-së me 25 qershor dhe a do mbyllet brenda afatit 8-javor i përcaktuar nga udhëzimi i kreut Basha?**

Procesi po ecën në përgjithësi me ritmin e kërkuar. Në të 12 qarqet, procesi ka kapur tashmë ritmin e plotë të tij. Dhe kjo jo vetëm për meritë të grupeve të punës nga qendra, por mbi të gjitha për meritë të anëtarësive dhe strukturave të PD-së që po i përgjigjen me përgjegjësi politike kë të procesi. Unë vë re me kënaqësi një nevojë të brendshme të demokratëve për të diskutuar haptazi dhe me seriozitet aspekte të ndryshme të zgjedhjeve të përgjithshme 2017. Procesi do të mbyllet brenda këtij viti. Gjithsesi, më e rëndësishme se kohëzgjatja e procesit, është cilësia e tij. Për këtë arsye jemi munduar që procesin e dëgjësës, konsultimit dhe analizës me



Enno Bozdo sekretari organizativ i PD-së

anëtarësinë, ta kanalizojmë në "shina" sa më të qarta. **Ju jeni i deleguari i gendrës në degën e PD-së së Beratit, si është gjendja e strukturave atje dhe çfarë po konstatojnë prej demokratëve beratas?**

Demokratët po denoncojnë me zë të lartë. P.sh., në qarkun e Beratit droga është mbjellë thuajse në të gjithë sipërfaqen e këtij qarku. Nuk ka asnjë fshat sot nga i cili të mos marr denoncime për sipërfaqe të mëdha të kanabisit të mbjellë dhe ekzistencës së punishteve të përpunimit të drogës. Qartazi ky fenomen kriminal, si dhe mbështetja e dukshme e dhënë nga policia për të, ka pasur një pesë të rëndësishme në rezultatin elektoral, në dëm të PD-së. Një shkak tjetër më pak i përmendur, por gjithsesi shumë i rëndë, është edhe abuzimi që pushteti vendor, (në këtë qark i dominuar tërësisht nga e majta) ka bërë me shpërndarjen e ndihmës ekonomike. Malësia e qarkut të Beratit rënditë ndër zonat më të varfëra

të Shqipërisë. Varësia ndaj ndihmës ekonomike është e qenësishme dhe në zona

### DËSHMITË

"Kam marrë shumë dëshmi të identifikimit me "emër dhe mbiemër" të mbjellësve të drogës, të shpërndarësve të parave në zona të caktuara, të kasnecëve monetare si dhe të atyre zyrtarëve që bënin presion me ndihmën ekonomike dhe me vendin e punës. Të gjitha këto do të dokumentohen", -tha z.Bozdo.

të caktuara shkon deri në 60% të popullatës. Presioni që i është bërë votuesve në këmbim të ndihmës ekonomike dhe "Kemp"-it është një fakt që rezultoi i shtrirë në të gjithë zonën. Presioni i të majtës me punësimin në këtë rëndë. Është një formë tjetër kjo më e sofistikuar, por po aq e dhunshme, e vjeljes së votës "me hir apo pahir". Do të veçoja këtu zonën e Skraparit, ku duke dëgjuar dëshmitë e demokratëve, mu kujtua fushata e vitit 1991.

**Po për sa i përket diskutimit për çështje të brendshme të PD-së, çfarë po konstatojnë?**

Procesi i konsultimit dhe analizës fokusohet, gjithashtu, në çështje të brendshme të organizimit të Partisë, apo në vektorë të ndryshëm të fushatës të cilët frenuan PD-në lokale të arrinte një rezultat pozitiv. Dhe këtu ka shumë punë për të bërë. Për këtë arsye, unë po fokusohem veçanërisht në identifikimin e problemeve të brendshme strukturore, si p.sh. aftësia e strukturës për të mbuluar territorin apo edhe rritjen e efencës së mesazhit politik nga PD-ja lokale drejt banorë vetë kësaj zone.

**A janë identifikuar blerësit e votave të 25 qershorit dhe çfarë do të bëjë PD-ja pasi të ketë listën e emrave të tyre?**

Unë kam marrë shumë dëshmi të identifikimit me "emër dhe mbiemër" të mbjellësve të drogës, të shpërndarësve të parave në zona të caktuara, të kasnecëve monetare si dhe të atyre zyrtarëve që bënin presion me ndihmën ekonomike dhe me vendin e punës. Të gjitha këto do të dokumentohen. PD do të marrë të gjitha hapat e nevojshme politike dhe ligjore për të trajtuar këtë fenomen.

**Konkretisht çfarë do të bëhet me të dhënat që po merrren nga "terreni"?**

Të dhënat që do të marrim nga terreni janë të një rëndësie të dorës së parë



Një nga protestat e PD-së në bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

### PROTESTA

"Protestat duhet të nisnin kur jo vetëm PD-ja, por edhe faktorët e tjerë socialo-apolitikë, të jenë të gatshëm t'i bashkëngjiten kauzës së protestës. Nuk ka rëndësi data, por procesi për të mbërritur deri këtu. Procesi sjell suksesin, dhe jo dëshira për të demonstruar aftësinë për të mbajtur protesta",-tha z.Bozdo.

për sa i përket betejave të ardhshme elektorale të PD-së, që po afrohen shumë më shpejt nga ç'ishte menduar. **Pas humbjes së 25 qershorit, ku duhet të përqendrohet PD-ja?**

Veçanërisht në situatën e kriminalizimit të skajshëm të qeverisjes, e paprecedentë në 25 vite të funksionimit të sistemit demokratik, PD-ja e ka të domosdoshme të ngrëjë në shkallën më të lartë aksionin politik të saj. Për t'i demonstruar shqiptarëve që ajo, vetëm ajo dhe askush tjetër, do të mund të nxjerrë vendin nga spirala e vdekjes së shpresës dhe e shpërbërjes së moralitetit shoqëror. Kjo nuk është thjeshtë një detyrë opozitare, por mbi të gjitha detyrim sho-

qëror dhe moral i PD. Me aksion politik nuk nënkuptoj thjeshtë protestën e radhës. Protesta nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, ajo është vetëm një instrument. Me aksion politik kuptoj përcimin e idesë së ndryshimit të shtresat shoqërore, të cilat janë të domosdoshme të jenë në të njëjtën anë të barrikadës me PD-në. PD-ja në mënyrën më të natyrshme është aleat i shtresës së mesme që si rregull mbart vlerat shoqërore në çdo shoqëri dhe në çdo kontekst historik. Qeverisja 2005-2013 e PD-së, shënon përpjekjen e parë "inxhinierike" për të formësuar shtresën e mesme në Shqipëri. Kjo përpjekje rezultoi përgjithësisht e suksesshme. Në këtë kontekst PD-ja duhet veçanërisht të targetojë shtresën e mesme në mesazhin politik të saj. Dhe siç kam thënë edhe në një intervistë të mëparshme me ju, përveç përcjelljes së mesazhit (që PD po e realizon në mënyrën e saj tradicionale), shumë rëndësi ka edhe medium apo mesazheri. Kjo shtresë kërkon të shikojë vetveten, pra të komunikojnë me të ngjashmin e saj. Jo thjesht me "zë dhe figurë", por mbi të gjitha me reputacion individual. Në morinë e mesazheve politike që PD përcjell, ky fakt duhet të mbahet parasysh.

**Ju thonë që protesta është vetëm një instrument, çfarë nënkuptoni me këtë?**

PD-ja ka treguar se është e aftë të realizojë protesta në çdo kohë dhe në çdo rrethanë. Në mandatin e parë të kësaj qeverie, PD arriti të organizojë protestat me masive në historikun e pluralizmit, të cilat kulmuan me protestën 90 →





◀ ditore në "cadrën n e lirisë". Prandaj nuk dua të shoh thjesht protestën e radhës dhe arsyetimin se "PD po bën detyrën e saj, por kërkohet në shumë përgjigje qytetare". Tashmë rrethanat kanë ndryshuar shumë, për fat të mirë, në favor të kauzës qytetare të PD-së. Opinioni publik është i bindur nga faktet e fundit se ajo çfarë Rama ofron është një mos qeverisje nën efektin e kanabisit, ku krimi organizuar dhe tentakulat korruptive bëjnë ligjin në një vend me institucione gjithnjë më të dobëta, si Shqipëria. Përballë kësaj gjendjeje, shtresa e mesme dhe e mesme e lartë, si kurrë më parë, ka zgjedhur të braktisë vendin. PD duhet t'i demonstrojë kësaj shtrese se meriton besimin e saj, se meriton t'i jepet një shans për të qeverisur. PD duhet t'ia shtrijë dorën e bashkëpunimit. Duhet të kërkojë mbështetjen e saj pa kushte. Dua të shoh të një PD që njehet me vullnet të mirë me qytetarinë shqiptare. Ashtu siç bëri në 1991 dhe në 2005. Veçse sot në kushte emergjente. Vetëm pasi të bëjmë këtë, do kemi bërë detyrën tonë me ndihmën e protestave!

**Megjithatë PD dhe LSI kanë paralajmëruar protesta për rrëzimin e qeverisë...**

PD-ja është e gatshme për këtë aksion. Aksioni është kundër krimit, drogës dhe korrupsionit. Por, siç përpigëmet të argumentoj më sipër, protestat duhet të nisnin kur jo vetëm PD-ja, por edhe faktorë të tjerë social-apolitikë, të jenë të gatshëm t'i bashkëngjiten kauzës së protestës. Nuk ka rëndësi data, por procesi për të mbërritur deri këtu. Pro-

cesi sjell suksesin, dhe jo dëshira për të demonstruar aftësinë për të mbajtur protesta!

**A besoni se përballë një maxhorance të madhe në numër, opozita duhet të jetë më e fortë, më "luftarake" sidomos në parlament?**

Latinët shpreheshin: "extremis malis, extrema remedia". Në kushte të jashtëzakonshme, kërkohen veprime të jashtëzakonshme. Aksioni parlamentar, sado i rëndësishëm të jetë ai, është veçse një nga instrumentet e aksionit politik. Tribunet e Lëvizjes Demokratike së vitit 1990, lëvizje që përmbysi regjimin më brutal në historinë evropiane të pasluftës, nuk iu drejtuan parlamentit, por shqiptarëve. Historia nuk përsëritet dy herë njësoj, dhe s'ka sesi, por përpjekjet nuk mund dhe nuk duhet të rreshtin.

**PD-ja përveç kundërshtarit politik prej kohësh ka një debat të brendshëm ku shënjestër mbetet kreu Basha prej kritikëve të tij.**

Asnjë kritikë e bërë me arsye dhe qëllim të mirë nuk mund të dobësojë PD-në. Përkundrazi e bën PD-në më të hapur, më immune dhe i jep mundësinë të vetshërohet.

**Por a janë të gjitha kritikët të tilla?**

Kam dyshimet e mia në këtë pikë. Goditjet personale të fshehura nën petkun e kritikës, por edhe kritikë e kritikës së shëndetshme, dëmtojnë njëllëj Partinë Demokratike.

**Thirrjes së z.Basha për bashkim, kritikët i janë përgjigjur me kërkesën për zgjedhje të reja në parti, por në gjykimin tuaj çfarë mund ta bashkojë PD-në dhe si mund të ringrihet**

## Skandalet e drogës, Vokshi në PPE: Rama, po shantazhon median PD: Qeveria e lidhur me organizatat kriminale

PD-ja akuzon kryeministrin Edi Rama se po ushtron presion ndaj mediave dhe gazetarëve për të fshehur skandalet e drogës dhe korrupsionit. Kryetarja e Komisionit Parlamentar të Medias, Albana Vokshi informoi Forumin e Gruas së Partitë Popullore Europiane rreth përkëqësimit të Lirisë së Medias në Shqipëri, sipas saj, një taktikë e kryeministrit për të penguar publikimin e lidhjeve të qeverisë së tij me organizatat kriminale. "Kryeministri i Shqipërisë po shantazhon dhe kërcënon gazetarët për të mbuluar skandalet me trafikim të drogës dhe aferat korruptive, të ministrave të rëndësishëm të qeverisë së Tiranës"- tha Vokshi në takim në Berlin, ku Forumi i Grave të PPE i kërkoi Komisionit European të mbështesë li-



Kryetarja e Komisionit Parlamentar të Medias, Albana Vokshi në PPE

rinë dhe pavarësinë e medias. Zonja Vokshi theksoi se përgjimet e Anti-mafias italiane, ku implikohet ish-ministri i Brendshëm, Saimir

Tahiri dhe fushata elektorale e PS, faktajnë blerjen e rezultatit zgjedhor në qershor 2017. "Përgjimet e Antimafias italiane, tha zonja Vokshi në

fjalën e saj, vërtetuan denoncimet disa vjeçare të PD-si dhe raportet e OSBE-ODIHR për blerje vote, kërcënime dhe trembje të votuesve nga anëtarë të organizatave kriminale. Për të kontrolluar publikimet e skandaleve qeveritare, kryeministri po bën çdo përpjekje për të intimiduar lirinë e gazetarëve dhe lirinë e shprehjes". - tha Vokshi. Kryetarja e LDG-SH-së kërkoi nga Forumi i Gruas së PPE të reagojë ndaj përkëqësimit të lirisë së medias. Në këtë takim, përveç kryetares Doris Pack, ishte edhe Dunja Mijatovic, eksperte për të Drejtat e Njeriut dhe Lirinë e Medias, e cila ka mbajtur deri në 2016-ën postin e Shefes së OSBE për Lirinë e Medias.

### KRIKIKËT

"Goditjet personale të fshehura nën petkun e kritikës, por edhe kritikë e kritikës së shëndetshme, dëmtojnë njëllëj Partinë Demokratike",-u shpreh z.Enno Bozdo.



Lulzim Basha, kreu i PD-së

**sërish ajo?**

Lulzim Basha është kryetari legjitim i PD-së. Çdo retorikë mbi këtë çështje e devijon debatin në personal. Ndërkaq, ka çështje të tjera shumë të rëndësishme ku palët mund të gjejnë terrenin e përbashkët. Ndryshimi statutor mund të jetë një e tillë. Vullneti i mirë për të kontribuar për PD-në, veçanërisht i atyre që

kanë marrë në kthim shumë nga PD-ja, është çelësi i zgjidhjes. Ne nuk duhet të lëmë mbrapa askënd, aq më tepër pjesëtarë të familjes tonë. Po ekzistoi ky vullnet, gjithçka është e mundur. PD do të ringrihet dhe do të përmbushë misionin e saj. Madje shumë më shpejt nga

çfarë mund të mendohet. **Pse kaq i lehtë bashkëpunimi me LSI-në, ndërkohe që ajo ishte pjesë e qeverisjes së majtë për 4 vite me radhë? PD dhe LSI janë pjesë e Frontit opozitar, por aleanca me partinë e Kryemadhit a po e zbeh forcën opozitare të PD-së si partia më e madhe e opozitës në vend?**

PD-ja është flamurtare e luftës kundër krimit të organizuar që po qeveris vendin, e luftës kundër drogës dhe parave të saj që po kapin çdo institucion, e përbaljes me kryeministrin Rama që me qeverisjen e tij i ka futur shqiptarët në krizën më të madhe të besimit pas asaj që shkaktoi regjimi totalitar i Hoxhës. PD dhe vetëm PD ka të drejtën morale ta mbajë lart këtë flamur, për shkak të opozitës së saj dhe memories historike që mbart. Për këto çështje ka madhore, PD nuk mund t'i mbyllë derën askujt që do t'i bashkëngjitet kësaj kauze. Ky nuk është një "bashkëpunim i lehtë", siç e quani ju. Ky është një bashkëpunim i përcaktuar nga rrethanat ekstremalisht të rënda ku ndodhet vendi. PD-ja nuk mund të sillet si femijë egoist që përjashton këdo nga lodrat e veta, sepse opozitarizmi në këto rrethana është vital. PD-ja duhet të tërheqë pas vetes të gjithë, madje edhe socialistët e ndershëm që nuk janë dakord me Ramën dhe qeverisjen e tij, e jo më t'i mbyllë derën atyre që janë rreshtuar pas saj!

### PËR LSI-NË

"PD nuk mund t'i mbyllë derën askujt që do t'i bashkëngjitet kësaj kauze. Ky nuk është një "bashkëpunim i lehtë", siç e quani ju. Ky është një bashkëpunim i përcaktuar nga rrethanat ekstremalisht të rënda ku ndodhet vendi". - theksoi sekretari organizativ i PD-së .

**E keqja nuk mundet me slogane, por me forcën që rrethanat diktojnë. Fitorja e kësaj kauze është në rrafshin politik, fitore e PD-së. Në rrafshin shoqëror, e të gjithë shqiptarëve!**

**Manovroi me 60 km në orë, mermeri bie nga kamioni në makinë**

**Aksidenti tragjik në Lushnje, në pranga shoferi i kamionit**

**P**olicia e Lushnjës vuri në pranga drejtuesin e kamionit që shkaktoi aksidentin me vdekje në rrugën Lushnje - Berat. Në këtë ngjarje humbi jetën gazetarja e emisionit "Stop" në TV Klan dhe u plagosen tre pjesëtarë të familjes së saj. Mësohet se 41-vjeçarja Pula ka kryer një parakallim të shpejtë pavarësisht ngarkesës me tonelata mermeri që kishin të kamioni. Bashkim Pula, i cili nuk i përmbyt rregullave të

**AKSIDENTI**

Në një segment në të cilin duhej të ishte me 40 km në orë, ai manovroi me 60 km në orë. Frenoi kur pa makinën përballë dhe në atë kohë nga karrocERIA e kamionit u shkëput guri i mermerit. Kjo manovër e gabuar shkaktoi aksidentin tragjik të shtunën në rrugën Lushnje-Berat, pranë fshatit Çiflik.

qarkullimit rrugor dhe u bë shkak i një aksidenti tragjik ndodhet tashmë në qeli, pasi policia e Lushnjës i vuri prangat. Në një segment në të cilin duhej të ishte me 40 km në orë, ai manovroi me

60 km në orë. Frenoi kur pa makinën përballë dhe në atë kohë nga karrocERIA e kamionit u shkëput guri i mermerit. Kjo manovër e gabuar shkaktoi aksidentin tragjik të shtunën në rrugën Lush-

nje-Berat, pranë fshatit Çiflik. Guri ra në rrugë dhe më pas në mjetin tip "Peugeot" me të cilin po udhëtonte drejt Skraparit familja Isufaj. Gazetarja e emisionit "Stop" në TV Klan, 24-vjeçarja Erinolda Isufaj, e cila ndodhej në sediljen e pasme ndërroi jetë rrugës për në spital. Sipas bluve makina tip "Peugeot", me të cilin po udhëtonin 4 persona është shkatërruar plotësisht. Në automjet ndodheshin prindërit e 24-vjeçares Shkëlqim dhe Dituri Isufaj, 51



Gazetarja 24-vjeçare, Erinolda Isufaj

e 50 vjeçe dhe dhëndri i tyre Marko Idrizi 29 vjeç. Për nxjerrjen e të plagosurve nga autovetura u desh ndërhyrja e ekupeve të specializuara. Familjarët e gazetares Isufaj ndodhen në

spitalin e traumës në Tiranë. Në momentin e aksidentit makinat ishin ballë për ballë dhe Pula transportonte dy blloqe gurësh mermeri, nga Berati në Tiranë.

Liroi Gent Dodën, prokuroria zbardh skemën korruptive: Lekët u dorëzuan në një lokal në Fushë Krujë

**Krimet e Rënda burg për gjykatësin Shkëlqim Miri**  
*Avokati Visha: Paratë të ligjshme, vuan nga tumori*

Ina Allkanjari

**G**jkata e Krimeve të Rënda dha dje masën e sigurisë "Arrest me burg" deri në përfundim të hetimeve, ndaj gjyqtarit Shkëlqim Miri. 46-vjeçari Miri, i cili u ndalua dy ditë më parë në kuadër të operacionit policor "Një vrasje e dytë", akuzohet për veprën penale të korrupsionit të funksionarëve të drejtësisë. Gjyqtari i Apelit të Tiranës, dyshohet se favorizoi të dënuarin Gentian Doda duke i ndryshuar akuzën nga vrasje me paramendim në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen, kundrejt një shume të konsideruar parash. Në seancën gjyqësore të zhvilluar pa praninë e mediave, mësohet se pati debate të forta mes organit të akuzës dhe avokatit mbrojtës të Shkëlqim Miri. Ndërkohë avokati i Miri, Ardian Visha deklaroi se klienti i tij vuan nga një sëmundje tumorale në kokë dhe paratë e gjetura në shtëpinë e tij do të përdoren për kurimin e gjyqtarit. Sakaq sot pritet të dalë para gjykatës edhe kushëri i gjyqtarit, Kujtim Miri, që shihet si njëri nga ndërmjetësit në këtë aferë korrupsioni.

**SEANCA GJYQËSORE**  
Në seancën gjyqësore, e cila zgjati 2 orë e 15 minuta, pati debate të forta mes organit të akuzës dhe avokatit mbrojtës të Shkëlqim Miri. Në seancën me dyer të mbyllura mësohet se përfaqësuesi i akuzës paraqiti përpara togave të zeza, përgjimet telefonike dhe pamjet filmike të një lokalit në Fushë Krujë si prova të forta kundër gjyq-



Gjykatësi Shkëlqim Miri

**300**

**MILION LEKË**

Ditën e premte me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është ushtruar kontroll në banesën e gjyqtarit Shkëlqim Miri, ku u gjetën dhe u sekuestruan 300 milionë lekë.

tarit Miri. Konkretisht paraqiti përgjimet e kryera nga grupi hetimor ndaj kushëririt të gjyqtarit, Kujtim Miri, i cili shfaqet në kamera duke marrë një valixhe me lekë, të dorëzuara nga ndërmjetësi tjetër Alban Buçi, aktualisht i shpallur në kërkim. Prokuroria thotë se menjëherë pas dorëzimit të parave, Gentian Doda është njoftuar në "Whatsapp" nga Alban Buçi se porosia u krye. "Rri pa merak, i dorëzuar dokumentet. I thamë s'kemi gjë tjetër, vetëm shpirtin. Do të dalësh nga mesi i muajit tjetër", thotë

ndërmjetësi Buçi. Këtë njoftim të cilin Prokuroria e Krimeve e përdori si provë në gjykatë ka mundur ta realizojë nga përgjimet e kryera edhe në burgun e Fushë Krujës të dy telefonat që përdorte Gentian Doda. Ndërsa gjyqtari Miri i pranishëm në sallë mësohet se përmes avokatit, ka kërkuar lirim nga qelia dhe hetim në gjendje të lirë pasi vuan nga një sëmundje e rëndë.

**REAGIMI I AVOKATIT**  
Pas përfundimit të seancës gjyqësore të zhvilluar dje ndaj Shkëlqim Miri, Ar-

**AVOKATI**

**ARDIAN VISHA**

Klienti im ka 25 vite që punon me një rrogë të konsiderueshme. Edhe bashkëshortja me rrogë të konsiderueshme. Ka problematikë shëndetësore. Në fund të majit është ekzaminuar në Gjermani me tumor në kokë. Paratë do të përdoren për kurimin e tij.



dian Visha ka deklaruar për mediat se ndalimi i gjyqtarit ishte i paligjshëm dhe se nuk kishte prova të mjaftueshme për ta lënë Mirin në burg pasi paratë e gjetura në shtëpinë e tij ishin të justifikuara me ligj. Gjithashtu, avokati tha se në muajin maj gjyqtari është ekzaminuar me tumor në kokë në Gjermani. "Shuma është relative në kushtet ku jetojmë. Ky gjyqtar ka 25 vite që punon me një rrogë të konsiderueshme. Edhe bashkëshortja me rrogë të konsiderueshme. Ka problematikë shëndetësore. Në fund të majit është ekzaminuar në Gjermani me tumor në kokë. Një pjesë e parave ishin të tija, ndërsa të tjerat ishin pjesë e një marrëveshje kontraktuale me një familjar. Paratë do të përdoren për kurimin e tij. Ka mungesë relacioni logjik

**HETIMI**

Prokuroria thotë se menjëherë pas dorëzimit të parave, Gentian Doda është njoftuar në "Whatsapp" nga Alban Buçi se porosia u krye. "Rri pa merak, i dorëzuar dokumentet. I thamë s'kemi gjë tjetër, vetëm shpirtin. Do të dalësh nga mesi i muajit tjetër", - thotë ndërmjetësi Buçi.

nga prokuroria, ka një dinamike prej janarit deri në fund maji, pastaj ka një boshllëk nga karakteri hetimor, pastaj prokuroria i kërkon gjykatës për të bërë kontroll në banesë. Natyrisht shfrytëzimi i bumit mediatic e ka bërë efektin, që u përdor nga prokurori për të kërkuar masën ekstreme. Detyrë e prokurorisë të provojë natyrën kriminale të parave të gjetura. Kjo gjë nuk u bë, as në akte, as nuk u provua. Po të kishte prova do ishte arrestuar para kontrollit të banesës. Ka qenë 3 herë në kontakt me policinë atë ditë, nëse do kishte rrezik do ishte larguar", - u shpreh avokati mbrojtës i Shkëlqim Miri, Ardian Visha. Lidhur me dorëzimin e parave në një lokal në Fushë Krujë Visha deklaroi se është detyrë e prokurorisë që të prodhohet natyrën kriminale të parave të gjetura dhe t'i lidhë me veprën që atribuohet konkretisht. "Ky ishte gjyqi i masës së sigurisë. Nuk kishte asnjë element provator që lidh marrjen e parave nga familjarët me gjyqtarin. Personi tjetër është kushëri i largët i tij", - tha avokati.

**SHKURT**

**Mali i Zi, policia sekuestron 33 kg marijuanë në kufirin me Shqipërinë**

Policia e Malit të Zi ka sekuestruar në kufirin me Shqipërinë 33 kilogramë marijuanë. Sipas televizionit shtetëror të Podgoricës, lënda narkotike po transportohej në vijën kufitare nga shtetas shqiptarë me anë të një mushke. Pasi ka parë policët, trafikanti ka hedhur drogën në tokë dhe është arratisur në territorin shqiptar. Agjentët nuk kanë bërë të mundur identifikimin e tij. Ndërsa bëhet me dije se autoritetet shqiptare janë informuar lidhur me ngjarjen. Gjithashtu, policia e Malit të Zi ka nisur hetimet për këtë rast.

**Shkodër, në pranga 51-vjeçari përdrangë të dashurën**

Shkodër-Policia e Shkodrës ka arrestuar një 51 vjeçar me iniciale E.P, pasi është denoncuar nga e dashura e tij për përndjekje. Sipas burimeve të policisë, pas ndarjes, 51 vjeçari ishte kthyer në shtëpisim për të dashurën e tij 10 vite më të re, me iniciale E.T. Edhe pse ajo i kishte kërkuar disa herë ta linte të qetë, 51-vjeçari e ndiqte vazhdimisht në rrugë si dhe e telefononte në çdo orë të ditës. Pas shtetësimeve të ditëve të fundit ajo ka bërë denoncimin në komisariat.



"Shtetasit që ranë në pranga kanë pasur komunikime me njëri-tjetrin"

# Droga në Velipojë, një prej të arrestuarve pranon të bashkëpunojë me drejtësinë

## Policia: Në verifikim aparatet celularë të të 7 të dyshuarve

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Vetëm një prej 7 të arrestuarve nga forcat e policisë të Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës ka pranuar që të japë më shumë detaje për drogën e sekuestruar prej 1.5 tonë në Velipojë në orët e para të mëngjesit të 11 nëntorit. Burime nga policia nuk bëjnë me dije se cili prej të arrestuarve ka pranuar që të flasë. Përdoruesi i fugonit, 20-vjeçari Jaho Berdo që u kap vetëm pas pak orësh në Vlorë ka thënë se do të flasë në një moment të dytë dhe as nuk ka pohuar dhe as mohuar në lidhje me akuzat e ngritura ndaj tij. Jaho Berdo përveçse kishte në përdorim fugonin ku u gjet droga mësohet se disponon edhe një patentë skafi. Policia dyshon se është pikërisht 20-vjeçari ai që do të bënte transportimin me skaf të drogës prej 1.5 tonë nga Viluni i Velipojës drejt shtetit fqinj të Italisë.



Droga e sekuestruar në Velipojë

### ARRESTIMET

Të arrestuar nga policia janë edhe Sokol Ujkaj, banues në Velipojë, i cili kishte në administrim shtëpinë ku u gjet droga. Banesa në fjalë është pronë e shtetasit Petrit Vuksani, por ky i fundit jeton në Itali dhe ia ka lënë në administrim Sokol Ujkës. Ujkaj është arrestuar brenda oborrit të shtëpisë, ndërsa aty kishte edhe makinën e tij tip "Mercedes benz" me targë AA 388 ME. Të arrestuar janë edhe efektivi i policisë Enriko Zyllo. Sipas burimeve Zyllo është parë afër shtëpisë ku u gjet droga me makinën e tij tip "Golf" me targë AA 355 SL ndërsa brenda mjetit ishte edhe shtetasi Gjovalin Ndoj nga Velipoja. Zyllo nuk

### PËRDORUESI I FUGONIT

Përdoruesi i fugonit, 20-vjeçari Jaho Berdo ka thënë se do të flasë në një moment të dytë. Ai as nuk ka pohuar dhe as mohuar akuzat e ngritura ndaj tij. Jaho Berdo përveçse kishte në përdorim fugonin ku u gjet droga mësohet se disponon edhe një patentë skafi.

i është bindur postbllokut të policisë dhe ka tentuar të largohet. Efektivët i janë vënë në ndjekje derisa e kanë arrestuar te vendi i quajtur Harku i Bërdicës pasi Zyllo doli jashtë rrugës nga shpejtësia. Edhe pse ka kundërshtuar, policia e ka arrestuar, ndërsa shtetasi Gjovalin Ndoj, që ishte me të, është larguar duke u shpallur në kërkim. Sokol Ujka dhe Enriko Zyllo janë të vetmit që janë arrestuar në

afërsi të vendit të ngjarjes. Nga ana tjetër, në pranga kanë rënë edhe shtetasit Arbër Bozhanaj, Genti Dano dhe Dervish Gjolekaj, të tre nga Vlora. Njëri prej këtyre 5 të arrestuarve sipas burimeve ka pranuar të bashkëpunojë, duke treguar më shumë detaje, ndërsa pjesa tjetër kanë refuzuar të pranojnë se kanë lidhje me drogën. Shtetasit e arrestuar kanë mohuar se kanë lidhje me njëri-tjetrin

apo se janë pjesë e grupit të trafikimit. Nga ana tjetër, policia ka mbledhur telefonat celularë dhe nga tabulatet, bëjnë të ditura burimet policore, se shtetasit që ranë në pranga kanë pasur komunikime me njëri-tjetrin. Pak orë më pas policia arrestoi edhe shtetasit Fation Merko, i cili ka qenë ai që ka bërë shoferin duke sjellë fugonin me drogë nga

### SEKUESTRIMI I CELULARËVE

Policia ka mbledhur aparatet celularë të personave të arrestuar për të nisur verifikimet e bisedave. Burimet policore bëjnë të ditur se nga kontrolli i tabulateve mësohet se shtetasit që ranë në pranga kanë pasur komunikime me njëri-tjetrin.

Vlora në Shkodër. Teksa Merko niste fugonin, efektivi i policisë Enriko Zyllo ka bërë rolin e garantit në këtë siguri dhe i ka shoqëruar gjatë udhëtimit. Policia me arrestimin e përdoruesit të fugonit Jaho Berdo e çoi në 7 numrin e të arrestuarve. Emrat e 4 të arrestuarve përveç shoferit Berdo, policit Enriko Zyllo dhe shtetasit Gjovalin Ndoj kanë dalë nga personi, i cili ka pranuar të bashkëpunojë, por që nuk bëhet i ditur për shkak të hetimeve. Sipas burimeve fugoni me sasinë prej 1.5 tonë cannabis sativa ka mbërritur natën e 11 nëntorit në Velipojë për t'i dhënë dorën e fundit përpara se të bëjë transportimin nga trafikantët.

Efektivët e kanë ndaluar njëherësh fugonin ende pa mbërritur te vendi ku u

gjet, por më pas e kanë lënë të kalojë duke e pasur nën kontroll për të ditur se cili ishte destinacioni dhe personat e tjerë që mund të ishin aty. Nga sa mësohet në policinë e Shkodrës ka pasur edhe një telefonatë se në shtëpinë e Petrit Vuksanit po bëhet një vjedhje pasi janë parë lëvizje të shpeshta, ndërsa personi që ka njoftuar nuk e ka ditur se aty po bëhej gati droga. Policia një vazhdon kontrollin në zonën e Velipojës ndërsa ka dyshime se edhe skafi që do transportohej 1.5 tonë cannabis sativa është i fshehur dhe po bëhen kërkime për ta gjetur. Pjesa fundore e Velipojës, e njohur si Viluni deri tek Rëra e Hedhur në afërsi të plazhit të Lezhës edhe më përpara është dyshuar si pikë e transportimit të drogës drejt Italisë.

## Vlera e drogës, më shumë se 1 milion euro

# Itali, në pranga tre shqiptarë, u kapën me 11 kilogramë kokainë

ITALI - Tre shqiptarë janë arrestuar nga policia italiane në Frosinone pas sekuestrimit të një sasie prej 11 kg kokainë, brenda një automjeti. Ky ishte bilanci i një operacioni brilant të përfunduar nga policia italiane dhe Guardia di Finanza. Ndërhyrja blic nisi gjatë natës së kaluar në përfundim të hetimeve që Guardia di Finanza kishte nisur në zonën hekurudhore, vendi i preferuar për përdoruesit dhe shpërndarësit. Pikërisht gjatë këtyre hetimeve, ishte pikasur një automjet "Volkswagen Tiguan" me targa



Droga e kapur në Itali

greke i dyshimtë në rrugë "Gaeta". Pas kryerjes së disa kontrolleve, rezultoi se pikërisht në atë zonë ishte rezidenti shtetas shqiptar me precedentet kriminale për veprën penale të shpërndarjes së drogës. Në këtë pikë, me ndihmën e kolegëve të skuadrës lëvizëse filloi një

shërbim vëzhgimi. Pas rreth 5 orësh monitorim, tre persona me origjinë shqiptare u panë të hynin në parkimin ku ndodhej makina me targa greke, që drejtohej nga një 60-vjeçar greke. Në atë moment policia ndërhyri. Nervozizmi i çuditshëm i treguar nga shqiptarët ka bërë dyshues efektivi që filluan të çmontonin makinën. Dhe vetëm me heqjen e një feneri, të vullosur mirë, u gjetën 11 kilogramë kokainë, nga të cilat do të nxirreshin rreth tetë mijë doza. Në tregun me pakicë, e gjithë kjo drogë do të sillte të ardhura shumë se 1 milion euro. Katër personat u arrestuar për trafik drogë. Gjatë operacionit janë sekuestruar edhe 5 automjete dhe 13 telefona. Ndërkohë që vijojnë hetimet për të zbuluar se nga ka ardhur droga dhe për kë ishte destinuar.

Studio Përmbartore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurine: "Apartament" me sipërfaqe 53.8 m2, me nr. Pasurie 2/189+13-135, Vol. 12, Fq. 125, Zona Kadastrale 8120, e ndodhur ne Rr."Shyqyri Peza", Pall. 6, Shk. 13, Ap. 135, Tirane, ne pronesi te bashkepronareve Sina, dhe e hipotekuar ne favor te banks. Cmimi me te cillin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 25,824 (njzete e pese mijë e treqind e njzete e kater) Euro Ankandi i pare zhvillohet me date 17.11.2017, ora 16:00 ne ambientet e Studios Përmbartore Shkrela me Adrese: Rruga Blv."Zogu i I", Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**  
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **5,680,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqjen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë parapikisht pagesën e pakthyesime prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**


Ofteta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **05 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**Gjykata: I paaftë të qëndrojë në burg**

**Lihet i lirë shqiptari, vrau ish-të dashurën**

**ITALI** - I ka shpëtuar dënimit të përgjeshëm 30-vjeçari shqiptar, Dritan Demiraj që u arrestua për masakrimin e të dashurës së tij dhe partnerit të saj të ri, Silvio Mannina. Gjykata e Apelit të Bolonjas ka anuluar dënimin e dhënë dhe ka vendosur këto ditë lirim të tij. Shkaku se pse ka ndodhur kjo gjë është gjendja shëndetësore e 30-vjeçarit shqiptar Pasi u masakrua në qelinë e burgut dhe ra në koma, Demiraj ka pësuar humbje kujtese dhe gjyka-

ta vendosi se ai është i paaftë të qëndrojë në burg. Gjykata e Apelit e Bolonjës ka vendosur këto ditë lirim dhe anulimin e dënimit për shqiptarin 30-vjeçar Dritan Demiraj, i cili masakroi ish-të dashurën e tij, Lidia Nusdorfi dhe 30-vjeçarin me të cilin vajza kishte krijuar një lidhje të re, Silvio Mannina. Mediat italiane shkruajnë se pas masakrimit në qelinë e burgut, agresori ra në koma, e pësoi humbje kujtese. Në vitin 2016, ai është sulmuar në burg nga një ish-boksier, i cili e kishte goditur për 15



Dritan Demiraj

minuta rresht në kokë me sende të forta. Demiraj vrau ish-të dashurën e tij rumune, Lidia Nusdorfi më 1 mars të vitit 2014 në stacionin e trenit në Rimini, pasi kishte vrarë më 28 shkurt të atij viti, Silvio Mannina-n, të dashurin e saj italian.

**U sulmua nga të dyja anët e makinës, dyshohet për 4 ekzekutorë**

**Atentat me armë në Athinë, plagoset rëndë 31-vjeçari shqiptar**

**GREQI** - Një 31-vjeçar shqiptar dhe një grek janë plagosur rëndë ditën e shtunën, në një atentat me armë në lagjen Pangrati të Athinës. Atandodheshin në një automjet në kohën që 4 ekzekutorët u afruan me dy motor dhe hapën zjarr me pistoletë. Makina ku udhëtonin shqiptari dhe greku 28-vjeçar ishte marrë me qira. Ngjarja ka ndodhur ditën e shtunë në orën 09:35 në kryqëzimin e rrugëve "Eftixidou" dhe "Vriaksidos". Drejtuesi ka arritur të lëvizë mjetin deri në kryqëzimin e rrugëve "Eftixidou" dhe "Ymitou" ku erdhën ambulancat. Atentatorët janë larguar me këmbë drejt Pagratis. Një nga të plagosurit



Atentati në Athinë

mori plagë në këmbë e tjetri në mes. Mediat greke thonë se dyshohet për 4 atentatorë. Njeri nga të plagosurit është në gjendje më të rëndë. Para ngjarjes dy të plagosurit kishin bërë sherr me një tjetër person jo shumë larg vendit të ngjarjes. Ndaj dyshohet se krimin shqiptari dhe greku 28-vjeçar ishte marrë me qira. Ngjarja ka ndodhur ditën e shtunë në orën 09:35 në kryqëzimin e rrugëve "Eftixidou" dhe "Vriaksidos". Drejtuesi ka arritur të lëvizë mjetin deri në kryqëzimin e rrugëve "Eftixidou" dhe "Ymitou" ku erdhën ambulancat. Atentatorët janë larguar me këmbë drejt Pagratis. Një nga të plagosurit

Trupi i shqiptarit të vrarë në Kretë, niset drejt atdheut

**Vrau me thikë shqiptarin, 26-vjeçarja greke pendohet: Nuk doja, nuk jam vrasëse**

**35-vjeçari Valton Loka babai i dy fëmijëve**

**M**e falni, nuk doja, nuk jam vrasëse", kështu mësohet të jetë shprehur dje përpara gjykatës 26-vjeçarja greke, e cila vrau me thikë shqiptarin Valton Loka. Gjykata greke ka caktuar masën e arrestit me burg për vrasësen e shqiptarit, prind i dy fëmijëve 15 dhe 7 vjeç. 35-vjeçari shqiptar gjeti vdekjen në përpjekje për të ndihmuar 26-vjeçaren, e skeduar si përdoruese droge. Mësohet se familja e tij që jeton prej kohësh në Ksiroptamo, Irakleo në Kretë dhe përballet me probleme ekonomike dhe gruaja e tij u ndodhën në vështirësi për sjelljen e trupit në Shqipëri, ku do të kryhet edhe ceremonia mortore. Ndërkaq mediat greke kanë publikuar edhe foton e autores, e cila mësohet se ishte e skeduar për vjedhje, por ishte jashtë hekurave për shkak të gjendjes shëndetësore. Ajo jetonte në një shtëpi që nëna e saj e kishte marrë me qira, ndërsa ka edhe një vëlla në burg në Koridhali. Shqiptari u sulmua me thikë nga fqinja 26-vjeçare, në shtëpinë e saj ku kishte shkuar i alarmuar pasi kishte dëgjuar që ajo bërtiste aq sa ngriti në këmbë lagjen. Pavarësisht faktit se ai i ofroi asaj ndihmë, vajza e re e qëlloi disa herë me thikë, duke i shkaktoar atij vdekjen. Ndonëse fqinjët njoftuan menjëherë ambulancën për ta transportuar me urgjencë drejt spitalit, plagët e marra rezultuan fatale për shqiptarin.



Viktima, Valton Loka



26-vjeçarja greke



**Gjyqi**

**MASA E SIGURISË**

Gjykata ka dhënë masën e sigurisë "Burg pa afat" për 26 vjeçaren greke që vrau shqiptarin, Valton Loka 35 vjeç. 26 vjeçarja greke ka thënë para trupës gjyquese: "Më vjen keq, nuk doja, nuk jam vrasëse".

lai. Familja e tij jetonte prej kohësh në Ksiroptamo, Irakleo në Kretë dhe përballet me probleme ekonomike, por me sa duket në këto ditë të vështira miq e të afërm 1 janë gjetur pranë, që Loka të prehej i qetë në Atdhe. **KUSH ISHTE VAJZA QË VRAU SHQIPTARIN** Ajo ishte lënë e lirë nga autoritetet vetëm disa orë përpara se të kryente krimin. Vajza ishte arrestuar dhe akuzohej për grabitje, ndërkohë që me kërkesë të prokurorit, një gjyqtar grek vendosi që 26-vjeçares t'i jepej një shans për t'u rehabilituar me qenë se është përdoruese droge. Kështu, e reja e cila është diagnostikuar edhe me HIV/AIDS,

monia mortore do të kryhet në Shqipëri. Trupi i tij është nisur dje rreth orës 18:00 (me atë lokale) në portin e Irakleos, ndërsa rreth orës 21:00 do të mbërrijë në Pire, për t'u nisur në pas drejt

Shqipërisë. Mësohet se bashkëshortes së tij dhe dy fëmijëve 15 dhe 7 vjeç u kanë ardhur në ndihmë dhjetra miq e të afërm. Trupi i pajetë i shqiptarit do të silltet në Atdhe nga bashkëshortja e vël-

u la e lirë me kusht disa orë para se t'i merrte jetën 35-vjeçarit shqiptar Valton Loka. Vajza ishte abuzuar seksualisht në moshë të re dhe gjatë viteve të fundit ka udhëtuar mes Athinës, Rodhosit, Kretës duke shitur trupin e saj. Në orët e para të së shtunës, ajo kishte marrë ndihmën e parë në spital për shkak të gjendjes së dobët nga përdorimi i drogës dhe më pas ishte kthyer në shtëpi. Gjatë mëngjesit, ajo doli para makinës së shqiptarit duke i kërkuar ndihmë. Valton Loka u ofrua ta ndihmonte dhe doli nga makina, por në këtë moment 26-vjeçarja e goditi me thikë duke e lënë të vdekur në vend. Krimi ndodhi përpara syve të bashkëshortes së 35-vjeçarit, e cila pësoi tronditje të fortë. Policia arrestoi menjëherë autorën e krimin dhe i gjeti dy thika, njëra me gjakun e viktimës. Dyshohet se ajo mund të ketë qenë e droguar në momentin e krimin.

**SHKURT**

**Makina del nga rruga në Kalimash, plagosen 2 persona**

Një aksident është regjistruar në rrugën e Kombit, ku një makinë tip "Volkswagen" ka dalë nga rruga dhe për pasojë janë plagosur dy persona. Sipas policisë, makina po drejtohej nga S.Gj., 29 vjeçe, banuese në Mirditë, e cila ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore dhe personi tjetër i plagosur është R.F. 32 vjeç, banues në Ferizaj, Kosovës. Ngjarja ka ndodhur në hyrje të tunelit të Kalimashit, ndërsa shkak për ngjarjen mendohet të jetë bërë prania e lagështirës në rrugë. Menjëherë në vendngjarja ka mbërritur shërbimi i ambulancës dhe të plagosurit janë dërguar në spitalin e Kulkësit. Sakaq, policia ndodhet në vendngjarje dhe po punon për shkaqet e aksidentit.

**Shqiptari i plagosur në Ekuador, policia jep detajet e arrestimit 3 vite më parë**

Shqiptari nga Kosova, Remzi Azemi, i cili mbeti i plagosur nga një atentat mafioz që iu bë në Ekuador, ishte një nga bosët e trafikut të drogës në këtë vend. Zyra e policisë së këtij shteti ka treguar historinë e grupit kriminal. Në vitin 2014 grupi i përbërë nga 12 anëtarë, u kap me 277 kilogram kokainë në tre operacione të ndryshme. Në pranga në qershorin e vitit 2014 ra dhe Remzi Azemi së bashku me dy shqiptarë të tjerë Pelivan R. dhe Lulëzim M. Së bashku me ta u arrestuan dhe 9 persona të tjerë mes tyre dhe një nga Greqia. Ende nuk dihet se si Azemi ka arritur të dalë nga burgu në atë pak kohë, por sipas autoriteteve, mendohet se atentati ndaj tij ka të bëjë me trafikun dhe përplasjen e grupeve rivale që operojnë në Ekuador.



## PENSIONET E INVALIDITETIT LLOGARITJA

Ja periudhat minimale që duhet të keni siguruar për pension të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm

# ISSH: Si do të llogariten pensionet e invaliditetit

## Dokumentacioni që duhet të dorëzoni për të përfituar

Voltiza Duro

Të gjithë ata persona që bëhen të paafte për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Në manualin e publikuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ditën e premte, përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë individi si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojë për të përfituar këtë pagesë. Sipas ligjit nr. 7703, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", indryshuar; invaliditeti klasifikohet në tri grupe. Invaliditeti i pjesshëm, është grupimi i parë, ku bëjnë pjesë të gjithë ata persona të siguruar që humbin aftësinë për punë në profesion, por janë ende në gjendje të kryejnë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAP-it. Në tëj grupi i dytë klasifikohet si invaliditeti i reduktuar në rastet kur personi i siguruar bëhet i paafte për çdo punë, ndërsa invaliditeti i plotë është grupimi i fundit i kësaj kategorie pensionesh nga i cili mund të përfitojnë të gjithë ata individë që ndodhen në kushtet e nevojës për kujdestari.

**INVALIDITETI I PLOTË**  
Pension invaliditeti të plotë përfitojnë të gjithë ata persona që kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paafte dhe moshës 20 vjeç. Gjithashtu, duhet që individi në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror si dhe të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale. E drejta për të përfituar këtë lloj pensioni fillon pas mbarimit të periudhës 6 mujore të trajtimit me raport mjekësor për paafte si të përkohshme në punë. Ndërkohë në manualin e ISSH-së bëhet me dije se masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i



**DOKUMENTET**  
Për të përfituar pension invaliditeti të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfituesi paraqitet në ALSSH të vendbanimit, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Përfituesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet përkatëse

pleqërisë. "Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar. Ndërsa shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1 % për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive", citohet në manual. Gjithashtu, ISSH bën me dije se shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Sipas ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në rastet kur përfituesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paafte dhe ka nevojë për një kujdestar të vazhdueshme nga një person tjetër; atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 % të bazës së vlerësueshme neto. Ndërsa, një person që merr pension invaliditeti të plotë e ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose

deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shkëputje nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 % të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 % e tij.

### PENSIONI I REDUKTUAR I INVALIDITETIT

Individët të cilët kanë humbur plotësisht aftësinë për të punuar, e që nuk kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit mund të përfitojnë pension të reduktuar invaliditeti. E drejta për të përfituar pension të reduktuar invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës

6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paafte të përkohshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajin e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe. ISSH thekson se masa mujore e pensionit të reduktuar të invaliditetit është e barabartë me masën e pensionit të reduktuar të invaliditetit të llogaritur sipas masës së pensionit të plotë të invaliditetit, shumëzuar me raportin e

viteve të periudhave të sigurimit, që janë periudhat e sigurimit që i duhen për pension të reduktuar të invaliditetit. Gjithashtu, në rastet që ka nevojë për kujdestari si dhe në rastet kur ka fëmijë në ngarkim, pagesat llogariten po njësoj si në pensionin e plotë të invaliditetit, me kushtet specifike përkatëse.

### DOKUMENTET

**Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**

- Fotokopje e Kartës së identitetit;
- Certifikatë e gjendjes familjare;
- Certifikatë martesë (vetëm për aplikueset femra);
- Dy fotografi.

**Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:**

- Libreza e punës;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
- Vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë (nëse periudha e punës nuk provohet me dokumente zyrtare);
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).

**Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:**

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

**Dokumentet që vërtetojnë gjendjen shëndetësore:**

- Fletë-drejtimi për në KMCAP, lëshuar nga institucione shëndetësore me shtretër, shoqëruar me fletë-dalje nga spitali, ekzaminime e dokumente të tjera plotësuese, të kërkuara kur del për herë të parë në KMCAP;
- Fletë-drejtimi nga KML për ato gjendje shëndetësore, që nuk janë objekt trajtimi në spital, 15 sipas përcaktimit në Rregullore;
- Epikrizë përcjellëse, lëshuar nga mjekë specialistë, apo konsulta e shoqëruar me ekzaminimet e nevojshme. Kur del për rikontroll duhet shoqëruar me ekzaminimet përkatëse zyrtare;
- Kartela personale dhe libri i shëndetit për të vërtetuar ecurinë e sëmundjes, ndjekjen dhe trajtimin mjekësor me ilaçe;
- Fletë-drejtimi për KMCAP, që vërteton rëndimin e gjendjes shëndetësore, e vlefshme për KMCAP, para afatit të rikontrollit;
- Raport mjekësor lëshuar nga Komisioni Mjekësor, që përcaktin gjendjen shëndetësore dhe aftësinë për punë (para fillimit të punësimit ose të përfshirjes në çdo skemë sigurimi);
- Raport mjekësor i lirimit nga ushtria, lëshuar nga KML pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak;
- Vërtetim për pagesën e paafte për punë, shkaktuar nga një sëmundje e përgjithshme (për punëmarrësin).

### PENSIONI I PJESSHËM I INVALIDITETIT

Ashu si në rastet e sipërpërmendura, personat që bëhen të paafte për të punuar përfitojnë në bazë të ligjit, pension të pjesshëm invaliditeti. Kushtet për ta përfituar

këtë pension janë po njësoj me kriteret e renditura për 2 pensionet e tjera të invaliditetit. Ndërkohë masa mujore e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Në manual

3

### KATEGORITË E PENSIONIT TË INVALIDIT

Invaliditeti klasifikohet në 3 grupe. Invaliditeti i pjesshëm, është grupimi i parë e bëjnë pjesë të gjithë ata persona të siguruar që humbin aftësinë për punë në profesion. Grupi i dytë klasifikohet si invaliditeti i reduktuar, ndërsa invaliditeti i plotë është grupimi i fundit i kësaj kategorie pensionesh.

in e Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit e llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

### DOKUMENTACIONI

Për të përfituar pension invaliditeti të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Përfituesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vërtetojnë moshën e identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. "Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit njohet datën për të kaluar në KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gjoriarisht dhe nëpërmjet vërtetimit tip. Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohe të KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.", thuhet në manualin e ISSH-së.

## SHKRIMTARET NE DIKTATURE LIBRI I KALOCIT

**EKSKLUZIVE** / Zbulohet dokumenti sekret i vitit 1970 për dënimin e disa prej sportistëve të Kombëtares

# Raporti sekret: "Njazi Lleshi, Dodan Përmeti dhe Spiro Gjika, u dënuan për kontrabandë valute"

*"Furnizues me dollarë i këtyre, kanë qenë persona të ndryshëm, si Jani Meksi, djali i një të burgosuri, Besnik Kodra, njeri pijanec etj."*

Dashnor Kaloçi

Në izolimin e plotë ku ndodh hej Shqipëria gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës deri në vitin 1990-të, përveç atyre që dilnin jashtë shtetit për arsye pune, si diplomatët, Marina Tregtare apo Agroeksporti, të vetmit shtetas që u jepje mundësia që të dilnin ndonjëherë jashtë, ishin artistët dhe sportistët, të cilët me dietat minimale që u jepje shteti i asaj kohe, nuk kishin mundësi që të blinin në shtetet ku ata shkonin diçka për vete apo familjarët e tyre. Por duke kursyer apo marrë ndonjë ushqim të thatë me vete, ata i përdornin dietat e tyre për të blerë ndonjë gjë të vogël, si: paketë cigare "Marlboro", çakmak, sapun, syze, letra bixhozi, (kështu quheshin letrat në atë kohë), apo në rastin më të mirë ndonjë bluzë me krahë të shkurtër, që kushonte më lirë. Por nisur nga dëshira e madhe që kishin shqiptarët në atë kohë për të pasur diçka ndryshe nga të tjerët, detyroheshin që të grumbullonin disa dollarë më tepër sa e lejonte rregulli, apo monedha floriri (Napolon flori apo Gjel) dhe fshehurazi doganierëve t'i nxirrnin ato jashtë për të blerë diçka më shumë. Si p.sh. orë dore (një Gjel floriri jepej për dy ora "Atlantic"), magnetofon, apo në rastin më të mirë, një aparat televizori. Mirëpo nxjerrja e valutës (dollarë, monedha floriri) jashtë shtetit më shumë se sa e lejonte ligji për ata shtetas që dilnin jashtë, konsiderohej kontrabandë dhe në bazë të ligjeve në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, quhej krim kundër shtetit dhe ata që kapeshin me këtë gjë, në rastin më të mirë përjashtoheshin nga puna apo sporti, ndërsa në rastin më të keq dënoheshin deri me burg. Për nxjerrjen e monedhave të floririt (Gjel apo Napolon) jashtë shtetit, sportistët kryesisht, detyroheshin që të përdornin lloj-lloj mënyrash për t'i shpëtuar kontrollit të doganierëve vigjilentë. Një prej këtyre mënyrave, ishte futja e tyre në kutitë e qumështit që prodhoheshin në kombinatin ushqimor "Ali Kelmendi" në Tiranë, gjë e cila bëhej që në momentin e prodhim-



Dr. Prof. Lluqa Heqimi duke u dekoruar "Nderi i Qarkut" Tiranë

it dhe sportisti që e bënte atë, detyrohej që kur të vinte nga jashtë, t'i sillte ndonjë gjë punëtorit të "ushqimores" që ja mundësonte atë marifet. Një prej tyre që e ka përuar vetë këtë fakt publikisht gjatë një emisioni televiziv (Histori me zhurmues, Tv Klan, viti 2011), është legjenda e sportit shqiptar, Ajtë Toska, Mjeshtër i Sportit në hedhjen e çekiçit. Kështu që nga

fillimi i viteve '60-të kur Shqipëria komuniste u shkëput nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të Europës Lindore dhe i mbylli kufijtë e saj, e deri në vitin 1990, një numër i madh shtetasish shqiptarë që u jepje mundësia për të bërë "rrugë jashtë", kryesisht sportistë dhe artistë, janë akuzuar dhe dënuar për "kontrabandë". Ndër ta ka pasur edhe mjaft per-

sonazhe të njohur, artistë dhe sportistë me emër të cilët kanë vuajtur edhe dënimin me burg. Si p.sh. në rastet e para që janë të njohura publikisht, është ai i Skënder Halilit, mjeshtër të madh të futbollit të ekipit "17 Nëntori" i Tiranës (emrin e të cilit sot e mban fusha sportive e ekipit Tirana), i cili në fundin e viteve '60-të, u dënuua me burg vetëm për dhjetë dollarë që iu gjetën mbi normën dhe dietën e lejuar. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në vitet që pasuan me sportistë dhe artistë të tjerë, të cilat tashmë janë të njohura edhe prej publikimit në shtypin e pas viteve '90-të. Si p.sh. shtangisti, Aleksandër Kondo, kampion absolut për disa vite me radhë, i cili në vitin 1984 u dënuua me prerjen e trajtimit ushqimor dhe mospjesëmarrje në disa aktivitetet ndërkombëtare, vetëm për një revistë pornografike që doganierët e Rinastit ia gjetën të fshehur në trup?! Apo rasti tjetër i futbollistëve të ekipit "Flamurtari" të Vlorës në mesin e viteve '80-të, të cilët gjatë kthimit nga Spanja (ku u ndeshën me ekipin "Barcelona" për Kupën e Kampioneve të Europës), u ndaluan në doganën e Hanit të Hotit, pasi kishin blerë më shumë paçka se u lejoheshin. Si p.sh. mbrojtësit të famshëm, Krapo Taho, doganierët i morën një fustan nusesh, që ai e kishte blerë për një person të



familjes. Por kjo gjë që ndodhi me Taho dhe disa shokë të tij të ekipit, të cilëve iu sekuestruan radio-magnetofona etj., ishte gjysma e së keqes. Pasi po atë ditë, në autobusin e tyre u gjet edhe një revistë pornografike, për të cilën ekipi do të kishte jo pak telashe?! Edhe pse "Flamurtari" i famshëm i atyre viteve bëri një epokë, duke kaluar disa herë turet në kupat e Evropës, regjimi komunist nuk i toleronte aspak. Ata duhet t'i nënshtroheshin të gjitha ligjeve dhe rregullave në fuqi, si të gjithë të tjerët?! Ndërsa, siç thamë pak më lart këto gjëra janë tashmë të njohura, në shkrimin e sotëm po publikojmë një dokument arkivor të vitit 1970, ku Prokurori i Përgjithshëm i Republikës, Lefter Goga, me anë të një raport-informacioni, njofton udhëheqjen e lartë lidhur me "impulimin e disa sportistëve të ekipit "Partizani", në kontrabandë valute". Dhe sportistët që kanë emrat aty, janë ish-ye të futbollit e basketbollit shqiptar, trajnerë dhe lojtarë të ekipeve kombëtare, si futbollisti Spiro Gjika, basketbollistët, Novruz e Dodan Përmeti, legjenda të basketbollit shqiptar ndër vite. Krahas këtyre emrave të njohur që prej vitesh mbajnë edhe titujt më të lartë si "Mjeshtër i Madh", etj., në dokumentin në fjalë përmendet edhe mjeku i shquar i ekipeve kombëtare, dr. prof. Lluqa Heqimi, një profesionist dhe njeri model, si atëherë dhe sot. Raport-informacioni në fjalë, i është dërguar Hynis Kapos, sekretar i Komitetit Qendror të PPSH-së që mbulonte në rrugë partie organet e diktaturës së proletariatit, (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Sigurimi i Shtetit, Hetuesia, gjykatat, prokurorinë, etj), i cili ka vënë dhe shënimin përkatës në atë dokument. Këtë raport-informacion të Prokurorit të Përgjithshëm ku propaganda e asaj kohe dhe ligjet strikte diskriminuese të regjimit komunist në fuqi kanë tentuar të përlejnë dhe t'i nxjerrin jo pak telashe emrave nga më të mëdhenjtë e sportit shqiptar, po e publikojmë të plotë dhe pa e cen-



Partizani kampion, 1971





← suruar aspak. Me të vetmin qëllim, për t'iu treguar brezit të ri që nuk e ka arritur atë kohë, se si funksiononte ai regjim edhe për ata sportistë që i ngrinin lart emrin dhe flamurin e Shqipërisë në pallatet e sportit dhe stadiumet e vendeve të ndryshme të botës.

**PROKURORIA E PERGJITHSHEME (DEGA E USHTRISE) INFORMACION MBI DISA ÇESHTJE, TE DALA NGA HETIMI I DISA KRIMEVE LIDHUR ME KONTRABANDEN E VALUTES**

Kohët e fundit, në Tiranë, janë ndjekur nga Prokuroria Ushtarake disa çështje penale me ushtarake, të akuzuar për krimin e shkeljes së dispozitave të valutës dhe të arit si dhe atë të kontrabandës.

Personat kryesorë të këtyre krimeve janë sportistë, të cilët kanë dalë disa herë me rradhë jashtë shtetit. Njerzit që u kanë dhënë atyre valutë, përveç shokëve të punës, kanë qenë dhe persona të tjerë të jashtëm, me qëndrime jo të mira politike, të cilët kanë mënyrë të ndryshme, janë munduar të afrohen me ta.

Në verën e vitit 1969, u procedua dhe u dënua futbollisti i Klubit "Partizani", oficer Spiro Gjika, ky është djali i një punëtori i rritur në jetimore, por duke rënë pas qejfeve, u shty të marrë valutë dhe të sjell plaçka nga jashtë shtetit kontrabandë.

(ka nxjerrë 337 dollarë dhe 1 napolon flori). Personat që i kanë dhënë valutë kanë qenë mësues të edukatës fizike si dhe disa të tjerë, me qëndrim moral jo të mirë, me të cilët mbante lidhje dhe shoqëri.

Kështu ka qenë berberi Ali Votopija - njeri i degjeneruar, rreth të cilit grumbulloheshin shumë sportistë, ku një pjesë prej tyre merrte dhe valutë prej tij. Po ky person, ndërmjetson për të krijuar lidhje të sportistëve dhe me njerëz të tjerë. Kështu, p.sh. Mina Kote, Kujtim Xhara, të dënuar me vonë për krime kundër shtetit dhe kontrabandë, janë interesuar dhe kanë dashur të njihen me Spiro Gjikën për t'i dhënë këtij dollar dhe zhvilluar kontrabandë.

Në fillim të këtij viti u proceduan dhe u dënuan për kontrabandë N/Oficer Pëllumb Shaqiri, sportist i Klubit "Partizani", Ali Lulolli, basketbollist i Klubit "Dinamo", e të tjerë. Furnizues me dollar i këto grupi, ka qenë i përmënduri, Ali



Partizani femra, kampion i Shqipërisë, me trajner Njazi Lleshin

Votopija si dhe Thoma Cikoni, rrobaqepës që ka njerëz jashtë shtetit.

Sportisti Ali Lulolli, ka qenë këshilluar vitin e kaluar për vepra të tilla. Megjithatë ay nuk hoqi dorë.

Materialet hetimore të mësipërme u punuan në klubet e ndryshme sportive, u vunë në dijeni qëndrat e punës si dhe institucionet qëndrore të tyre. Megjithatë rezultoi përsëri, se disa anëtarë të këtyre klubeve janë marrë dhe më vonë me valutë dhe kontrabandë.

Nga Klubi Sportiv "Partizani" u procedua N/Oficer Njazi Lleshi, trener i basketbollit për të rinjtë e "Partizani", N/ Oficer Novruz Përmeti, trener i vajzave dhe i pionerëve të Klubit Sportiv "Partizani", Dodan Përmeti, basketbollist i Partizanit, Lluk Heqimi, mjek, etj.

Furnizues me dollar i këtyre, kanë qenë persona të ndryshëm si Jani Meksi, djali i një të burgosuri, Besnik Kodra, njeri pijanec etj.

Pra, ndërsa personat që nxjerrin valutën, dhe blejnë plaçka kontrabandë, janë njerëz me përbërje të mirë politiko-shoqërore, persona që i furnizojnë këto me dollar, në një pjesë të tyre janë element me përbërje jo të mirë politike dhe morale dhe deri diku t'interesuar për të shtyrë të tjerët në krim, apo për të krijuar lidhje me t'a, siç është rasti i përmëndur më lart me oficer Spiro Gjikën.

Nga procesi i fundit del, se disa prej tyre si Dodan Përmeti, kanë pasur lidhje dhe njohje, nëpërmjet këtyre veprimëve dhe me persona të tjerë, dy prej të cilëve u arrestuan kohët e fundit për krime kundër shtetit.




Për të prevenuar këto krime, ne organizuam këtë muaj disa mbledhje të tjera me sportistët e këtyre klubeve, ku prokurori ushtarak i qytetit punoi konkluzionet e hetimit.

Në këtë proces implikohen mjaft persona, me përbërje politiko-shoqërore. Për këtë arsye një pjesë prej tyre nuk janë ndjekur penalisht, ndërsa për të proceduarit e grupit të fundit, kolektivi propozoi që t'ia lëmë atyre për edukim dhe të ndjekë nga afër përmirësimin e tyre deri në rehabilitimin e plotë. Ne pranuan propozimin e tyre, por megjithatë, mendojmë se puna politike dhe edukative e drejtuesëve të këtyre klubeve, të seksioneve të arsimit, e të tjerëve, muk ka pasur efektiviteten e duhur.

Në dhënien e këtij informacioni u nisëm nga fakti se, sikurse dihet rreth sportistëve të këtyre klubeve grumbullohen mjaft të rinj, gjë që munduam se ka interes për një trajtim më të kujdesëshëm të këtiio sektori. Nga hetimi del, se edhe të tjerë sportistë kur dalin jashtë shtetit, shifën të bredhin nëpër dyqane me valutë në dorë. Kjo, nga ana e jonë, u është vënë në dukje drejtuesëve kryesorë të këtyre klubeve për të nxjerrë detyra për trenerët dhe përgjegjësit që i shoqërojnë.

Lidhur me krimet e mësipërme dhe personat fajtorë, janë vënë në dijeni Komitetet e Partisë nga varen këto klube, Komandat dhe qëndrat e punës.

**Tiranë, më 3 IX.1970  
PROKURORI I PERGJITHSHEME (LEFTER SOGA)**



Ministria e Shëndetësisë: Furnizim me barna për 90 Qendra Shëndetësore në zonat e thella

Voltiza Duro

# Manastirliu: Bonus deri në 2.5 milionë lekë për mjekët

## "Do të plotësojmë mungesat e stafit"

Për plotësimin e mungesave të mjekëve specialistë në spitalet rajonale në vend, do të aplikohet bonusi që arrin shifrën 2.5 milionë lekë. Lajmi është bërë me dije nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë vizitës së djeshme në spitalin e Peshkopisë. "Në Dibër dhe spitalet e tjera rajonale do të plotësojmë mungesat e mjekëve specialistë duke aplikuar bonusin deri në 2.5 milion lekë", tha ministria. Ndërkohë ajo theksoi se ky spital, brenda muajit prill do të ketë gati instrumentet e rinj kirurgjikale, që do t'i japin fund një herë e mirë infeksioneve spitalore. Manastirliu u shpreh se falë projektit që do të realizohet me Bankën Botërore, brenda vitit 2018, ky spital do të pajiset me mamograf të ri, ekografi dhe të gjitha pajisjet e nevojshme. Gjithashtu, ajo nënvizoi se edhe poliklinika e qytetit të Peshkopisë, do të rikonstruktohet dhe pajiset me të gjitha pajisjet bio-mjekësore sipas planifikimit të buxhetit të vitit 2018. Mjeku kirurg në spitalin e Peshkopisë, Gazmend Xhembulla është



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë vizitës së djeshme në spitalin e Peshkopisë

shprehur se në këtë spital fatmirësisht nuk ka mungesë barnash që ndihmojnë në trajtimin e kurimit e pacientëve. Ndërkaq ministria e Shëndetësisë theksoi se do të mundësohet furnizimi me barna për 90 qendra shëndetësore në zonat e thella në të

gjithë vendin, brenda periudhës së dimrit. "Më vjen mirë që në Peshkopë shohim këtë situatë me barnat dhe dua të sjell në vëmendje edhe një angazhim tjetër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të garantuar që tani furniz-

### Manastirliu

**BONUSI PËR MJEKËT**

"Në Dibër dhe spitalet e tjera rajonale do plotësojmë mungesat e mjekëve specialistë duke aplikuar bonusin deri në 2.5 mln lekë. Dua të sjell në vëmendje edhe një angazhim tjetër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të garantuar që tani furnizimin me barna për 90 qendrat shëndetësore në zonat malore, për gjithë periudhën e bllokimit nga moti i keq" - tha Manastirliu.

imin me barna për 90 qendrat shëndetësore në zonat e thella malore, për të gjithë periudhën e bllokimit nga dëbora apo moti i keq", - u shpreh Manastirliu gjatë takimit. Gjithashtu, kjo e fundit ishte e pranishme edhe gjatë aksionit për çlir-



imin e hapësirave nga ndërtime të paligjshme brenda spitalit rajonal të Dibërs. "Jemi të vendosur t'i kthejmë personelit mjekësor dhe qytetarëve hapësirat e zëna pa leje me aktivitet, që nuk kanë aspak lidhje me spitalin", - u shpreh ministria.



### Aksioni, Bashkia mbjell 1000 pemë në Liqenin e Thatë

Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit ka mbjellë plot 1000 pemë të reja në zonën e Liqenit të Thatë në kryeqytet. Pjesë e këtij aksioni ishte dhe kryebashkiaku Erion Veliaj, i cili theksoi se ky projekt do të vijojë përgjatë gjithë unazës së jashtme të Tiranës, që është edhe kufiri i Pyllit Orbital. "Do ta thyejmë rekordin tonë, duke mbjellë mbi 100 mijë pemë këtë vit, vetëm nga energjia fantastike që po gjenerojnë në Tiranë të rinjtë, vullnetarët, kompanitë, shoqatat", tha ai. Veliaj e vlerësoi si shumë të rëndësishëm misionin për të shtuar gjelbërimin në qytet dhe ftoi bizneset apo individët e ndryshëm që të kontribuojnë, duke i lënë qytetit trashëgiminë më të mirë.

## SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE PRANË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të institucionit i Komisionerëve Publikë", shpall vendet vakante për pozicionet:

### Specialist Financë/Buxheti (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

### Specialist i Burimeve Njerëzore (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 4 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

### Specialist IT (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (WordPress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### Specialist Protokoll/Arkive (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

### 2 sekretare pranë Komisionerëve Publikë (kategoria e pagës sipas VKM nr. 187/2017)

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

- Të ketë njohuri shumë të mira të programeve kompjuterike Microsoft Office.
- Eksperienca në punë përbën avantazh.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 20 deri 24 Nëntor, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27 Nëntor 2017 dhe të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga zyra postare. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:


- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti)
- Dokumentat (diplomë, librezë pune, vërtetim, dëshmi, vetdeklarim, certifikata, trajnime etj) fotokopje ose të noterizuar. Diplomata që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (Vërtetim nga Gjykata, Vërtetim nga Prokuroria, Dëshmi e gjendjes gjyqësore)
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Një rekomandim nga punëdhënësi;
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumenta të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrajnë Komitetit ad-hoc dokumentat e njësuara ose ato origjinale.





## STUDIMI



Kujdes,  
kancer nga aparatet  
celularë, ja si duhet  
t'i përdorni

## NIGELLA SATIVA



Fara e zezë,  
bima çudibërëse  
që shëron çdo  
sëmundje

# Ronald Zeliya:



◆ Mjeku: Simptomat e para të sëmundjes, ja si të parandaloni komplikacionet

## Urgjencat diabetike, rritje e ndjeshme te të rinjtë

"Rreziku fatal që i kanoset pacientit"

• **Konsumoni çaj hitre kundër artritit e anemisë**

**Mjeku: Simptomat e para të sëmundjes, ja si të parandaloni komplikacionet**



Voltiza Duro

**D**iabeti i njohur ndryshe edhe si sëmundja e "fshehur" po pëson një rritje të shpejtë nga viti në vit edhe në vendin tonë. Nëntori është muaji i sensibilizimit në luftën kundër diabetit e shoqata të shumta në Shqipëri organizojnë aktivitete të shumta për ndërgjegjësimin, informimin mbi këtë sëmundje e pranimin e kësaj kategorie në shoqëri. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" mjeku Roland Zelija flet mbi urgjencat diabetike, të cilat janë hallkat e fundit të komplikacioneve që sjell sëmundja e diabetit. Ai shpjegon faktorët që çojnë deri në këtë pikë e mënyrat për t'i eliminuar apo minimizuar ato.

**Çfarë janë urgjencat diabetike?**

Urgjencat diabetike janë mjaft problematike dhe të vështira për t'u zgjidhur, sidomos në drejtim të diagnostikimit dhe trajtimit të tyre të shpejtë dhe të kualifikuar. Pavarësisht se diabeti është një sëmundje kronike, rastet, kur kjo sëmundje komplikohet me gjendje ku kërkohet ndërhyrje urgjente, janë të shpeshta. Themi urgjente për shkak edhe të fatalitetit që mund të kenë nëse nuk ndërhyhet menjëherë për të dalë nga kjo gjendje. Ndërlikimi i këtyre situatave me gjendje kome, konsiderohet urgjente dhe duhet të ndërhyhet menjëherë.

**A ka pasur rritje të numrit të tyre?**

Kohët e fundit vërehet një rritje e numrit të këtyre urgjencave me rreth 20% kjo për vetë faktin se kjo është një sëmundje me shumë masivitet në popullatë dhe vlen për t'u theksuar edhe një rritje e ndjeshme e numrit të pacientëve të rinj këto vitet e fundit.

**Ku duhet të tregojnë më tepër kujdes pacientët për të eliminuar apo minimizuar urgjencat diabetike?**

Dua të theksoj se urgjencat diabetike janë hallka e fundit e komplikimeve të diabetit ku pacienti është i rrezikuar. Pacientët t duhet të jenë shumë të kujdesshëm në lidhje me zbatimin e saktë të udhëzimeve dhe këshillave të mjekut të tyre endokrinolog. Është një sëmundje shumë delikate në tërësinë e saj, por që me respektimin e duhur nga ana jonë mund të mbahet nën kontroll.

**Çfarë është hipoglicemia dhe si shkaktohet ajo?**

Hipoglicemia është një ndërlikim shumë i shpeshtë i diabetit që ka të bëjë me uljen e sheqerit në gjak nën shifra 70 mg/dl. Shkaqet e saj janë të shumta ku mund të përmendim kryesisht dozën e gabuar të medikamentit që përdoret për diabetin apo dhe faktorë shpërthyes siç mund të jenë gjendjet septike insuficenca kardiake, insuficenca hepatike, insuficenca renale apo edhe deficite enzimatike të lindura, të cilat ndikojnë në uljen e sheqerit në gjak.

**Cilat janë disa nga shenjat që paraqesin pacientët?**

Klinikisht këta të sëmurë shfaqen me djersë profuse, me takikardi, shpesh me rritje të tensionit arterial me konfuzion mendor e me dobësi të theksuar trupore. Duhet theksuar që këto janë simptomat e para të hipoglicemisë. Stadi i fundit i saj është koma hipoglicemike, e cila karakterizohet nga humbja e plotë e ndërgjegjes, e cila shfaqet kryesisht kur niveli i glukozës në gjak është nën 50 mg/dl.

**Si mjekohen të sëmurët në këto situata?**

Mjekimi lidhet me normalizimin e nivelit të sheqerit në gjak. Mjekimi fillohet që në ambulancë dhe vazhdohet më pas në spital. Duhet theksuar se në rastet kur të sëmurët mjekohen me insulinë dhe kur dalin me pas nga ky ndërlikim ata mund të dërgohen në shtëpi dhe të porositën të marrin ushqim dhe të vazhdojnë me insulinën e radhës, ndryshe ndodh me të sëmurët që mjekohen me preparatet e sulfanilurese (me tableta) ku pacientët t nuk dërgohen në shtëpi, por mbahen në observacion nga mjekë t për shkak se gjendja e hipoglicemisë mund të ndodhë përsëri. Duhet të theksojmë që çdo i sëmurë me diabet duhet të ketë një farë informacioni dhe stili jetese, i cili ndihmon në parandalimin e këtyre komplikimeve.

# Ronald Zelija:

## Urgjencat diabetike, rritje e ndjeshme te të rinjtë

*"Rreziku fatal që i kanoset pacientit"*



Ronald Zelija

**Çfarë janë urgjencat hiperglicemike?**

Përveç urgjencave hipoglicemike kemi edhe ato hiperglicemike, pra me rritje të sheqerit në gjak. Koma hiperglicemike e lidhur me trupat ketonike dhe koma hiperglicemike e palidhur me trupat ketonike janë ndër urgjencat më madhore diabetike, të cilat kanë edhe mortalitet të lartë. Koma hiperglicemike e lidhur me trupat ketonike ose acidoketoza karakterizohet nga një rritje e sheqerit në shifra mbi 300 mg/dl dhe është një ndërlikim kryesor në diabetin e tipit 1.

**Cilat janë shkaktarët kryesorë të komës hiperglicemike?**

Shkaktarët kryesorë të tyre janë prishja e dietës së këtyre pacientëve apo edhe çrregullimi i marrjes se medikamentit që ato përdorin, që të parandalojnë sa

më tepër ndërlikimet. Të sëmurët me diabet duhet të jenë shumë rigorozë në dietën e tyre dhe në mënyrën e marrjes së medikamentit. Ndër faktorë të tjerë mund të përmendim infeksionet e ndryshme, të cilat shoqërohen edhe me temperaturë të lartë, përdorimi i medikamenteve që shkaktojnë hiperglicemi siç janë p.sh kortizonikë t apo diuretike t, traumat e forta psikomocionale negative apo dhe traumat e ndryshme fizike.

**Cilat janë shenjat e hershme të saj?**

Shenjat fillestare të hiperglicemisë janë anoreksia, nausea, të vjella, dhimbja e kokës e me pas etja e shtruar, urinimi i shpeshtë e dhimbjet abdominale. Nëse i sëmurë nuk merr ndihmë atëherë shfaqen edhe shenjat neurologjike të tilla si çrregullime të ndërgjegjes e që pasohen edhe me gjendjen komatoze. Në rastet e mosndërrhyrjeve mund të

shfaqen edhe dëmtime të tjera organore, siç mund të jetë insuficenca renale acute. Është pra shumë e rëndësishme që Hiperglicemia të diagnostikohet që në stadet e para të saj pa arritur në gjendje komatoze.

**Si mjekohet hiperglicemia?**

Mjekimi fillon që nga vetë i sëmurë. Ai mund të orientohet të kryejë një dozë insuline me veprim të shkurtër 6-10 unite gjithnjë nën konsultën e një mjeku dhe me pas të dërgohet në një qendër të specializuar për t'u plotësuar me analiza e për të vazhduar më tej me terapinë. Në mjekimin plotësues mund të futen edhe antibiotikë kjo në varësi të shkaktarit të kësaj gjendjeje, gjithsesi duhet theksuar se këto gjendje japin një dehidrim të trupit dhe kërkojnë edhe dhënien e substancave rehidruese (solucione fiziologjike).





**M**e zhvillimin që po pëson teknologjia çdo ditë e më shumë, na duhet të ndeshemi me valët elektromagnetike, të cilat përbëjnë rreziqe nga më të ndryshmet për shëndetin tonë. Përveç valëve të dritës, në ambientet ku qëndrojmë apo punojmë, dashur padashur preken nga valët e prodhuara artificialisht si nga stacionet e radios, televizorët, aparatet celularë e kompjuterët. Të gjitha këto valë transmetojnë energji në një masë të caktuar që shkaktojnë efekte mbi organizmin tonë.

#### RREZIKSHMËRIA

Elektromagnetizimi është një ndotje e "padukshme" me dëmtime serioze që mund të çojnë deri në zhvillimin e tumoreve, veçanërisht te fëmijët. Por ky problem "harrohet" nga shoqëria pasi jemi vetë në përdorues të kësaj teknologjie. Agjencia Rajonale për Ambientin dhe Instituti i Lartë për Kërkimet Ambientale në Itali, pas studimeve të kryera arritën në konkluzionin se shtimi i antenave të repetitorëve të frekuencave, arrin akses më të shpejtë në internet, por shton probabilitetin e prekjes nga sëmundjet. "Ne jemi të ekspozuar 100 milionë herë më shumë se stërgjyshërit tanë ndaj rrezatimit radioaktiv", thuhet në librin "Zapped" të autorese Dr. Ann Louise Gittleman. Hulumtuesit në Institutin Kombëtar për Shëndetësinë kanë zbuluar se vetëm mbajtja e një celulari aktiv afër kokës për 50 minuta, prodhon ndryshime të dukshme në metabolizmin

Studimet: Ndikimi i valëve elektromagnetike në shëndetin e njeriut, sëmundjet që shkaktojnë

## Kujdes nga aparatet celularë, ja pasojat e përdorimit të tepërt

*"Rrezik për zhvillimin e tumoreve"*



e trurit. Prof. Girish Kumar ka theluar kërkimet e tij mbi radiacionin e telefonisë celulare dhe efektet e saj, e ka dalë kundër përdorimit të shpeshtë të telefonave celularë, sepse përdoruesve iu shtohet risku nga kanceri, tumoret e trurit dhe rreziqe të shumta të tjera për shëndetin. Edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë i klasifikoi telefonat celularë si burim i mundshëm cancerogjen.

#### PASOJAT

Kur një person e përdor telefonin celular për 50 minuta pa ndërpre-

rje, indet e trurit nga ana e celularit metabolizojnë më shumë glukoze krahasuar me krahun tjetër. Dëmet e shkaktuara nga valët elektromagnetike të celularëve, mund të prekin edhe sterilitetin te meshkujt. Doktoresha Fiona Mathews doli në konkluzionin se sperma e atyre që mbanin telefonin në xhepin e përparmë, ishte 8% më e keqe në krahasim me të tjerët. Ndaj dhe do të ishte tepër e këshillueshme që të hiqni dorë nga zakoni i të mbajturit telefonin në xhepat e para të pantallonave, më mirë mbajeni në



xhepat e pasme. Radiacioni i celularëve është tepër i rrezikshëm edhe për fëmijët dhe gratë shtatzëna.

#### PARANDALIMI

-Telefonat celularë duhet t'i mbani në çantë, larg nga organet vitale, si dhe mos i mbani në xhepa.

-Të mos mbahet telefoni celu-

lar afër, nën jastëk, gjatë gjumit.

-Te shkurtohet koha dhe numri i telefonatave që bën duke përdorur telefonin celular.

-Të përdoren kujtet, sepse edhe me disa centimetra distancë, fusha elektromagnetike bie dukshëm në intensitet.

-Në shtëpi të përdoren telefona me tela të modës së vjetër, në vend të atyre bashkëkohorë pa tela.

-Të mbahet laptopi larg nga prehri, të vendoset në tavolinë.

-Të largohen të gjitha, apo shumica e pajisjeve elektrike nga dhoma e fjetjes.

-Të konsumohen ushqime dhe suplementare antioksidues, për të luftuar radikalet e lira që valët elektromagnetike krijojnë.

-Të përdoret teknologji tokëzimi për të stabilizuar ritmet elektrike të trupit dhe minimizuar efektet e interferencës së frekuencave elektromagnetike.

-Të mos qëndrohet gjatë pranë antenave të repetitorëve. Mirë është që këto antena të mos jenë pranë zonave të banuara.

Duke ndjekur hapat e mësipërm, probabiliteti për t'u prekur nga sëmundjet që shkaktojnë valët elektromagnetike zvogëlohet.

# Këshilla

## Fara e zezë, bima çudibërëse që shëron çdo sëmundje

**F**ara e zezë e njohur në gjuhën mjekësore si *Nigella Sativa* është një bimë, lëngu i së cilës ka efekte çudibërëse në shërimin e shumë sëmundjeve. Kjo bimë përmban vaj acidik të pangopur, vaj me eter, vitamina dhe një sërë substancash të tjera të domosdoshme për organizmin. Tashmë është vërtetuar se vaji acidik i pangopur që përmban fara e zezë ndikon pozitivisht mbi metabolizmin e trupit, rrit imunitetin dhe ndalon alergjinë. Gjithashtu, përdorimi i këtij vaji ndihmon në parandalimin e diabetit e rezultatet pozitive vërehen pas një muaji. Madje fara e zezë është një ilaç i mirë edhe në përmirësimin e memories pasi rrit fuqinë e trurit e përqendrimin. Bima çudibërëse e kombinuar me mjaltë ndihmon edhe në trajtimin e astmës, kollës e alergjive; ndërsa nëse përzihet me qumështin e dhisë bën të mundur parandalimin e sulmeve në zemër. Për të gjithë ata që vuajnë nga sëmundjet e syve si skuqje,



katarakt apo lotim duhet të përdorin vajin e farës së zezë pasi ka efekte të jashtëzakonshme në një kohë të shkurtër. Ndërkohë kjo bimë parandalon edhe formimin e gurit në veshka, ndikon në forcimin e dhëmbëve dhe trajtimin e sëmundjeve të tyre si dhe nëse e përdorni këtë vaj në masazhimin e

kokës, do të mundësojë parandalimin e humbjes së flokëve. Ndërkaq ata individë që vuajnë nga dhimbjet e kokës dhe migrena mund të përdorin këtë vaj për t'u kuruar. Nëse përzieni uthullën dhe mjaltin me vajin e farës së zezë, mund të lehtësoni dhimbjet dhe të parandaloni artritin. Vaji i farës së zezë kur përzihet me lëng rrushi është i mirë kundër kancerit, siç është ai i zorrëve, kanceri i gjakut dhe kancerit të fytit. Për këtë përzihen vaj i farës së zezë me lëng rrushi dhe përdoren tri herë në ditë që të ketë rezultate pozitive. Efekte të shpejta, vaji i farës së zezë ka dhe në qetësimin e dhimbjeve të stomakut nëse e pini 2-3 herë në ditë. Gjithashtu, për të rivitalizuar trupin, për të hequr lodhjen dhe dembelizmin, është sugjeruar që të përzieni vajin e farës së zezë me lëng portokalli. Kjo do të ndihmojë për të hequr pasivitetin dhe të bëjë trupin tuaj energjik.



## Konsumoni çaj hithre kundër artritit e anemisë

**N**ë mjekësinë popullore hithra njihet si mbretëresha e bimëve mjekësore, për shkak të efekteve të saj pozitive në shërimin e disa sëmundjeve. Përdorimi i kësaj bime ndihmon në pastrimin e gjakut dhe tek të sëmurët me anemi. Këshillohet që të konsumohet sa më shpesh bima e hithrës në formë sallate ose dhe e gatuar në supë ose byrek. Hithra përmban sasi të konsiderueshme të vitaminës A dhe C, vitaminë K, amin si histamina, serotoninë dhe minerale siç është hekuri shumë i rëndësishëm për organizmin e njeriut. Pra, për shkak të vlerave të shumta që ajo përmban dhe efektet e saj janë të menjëhershme. Gjithashtu, mund të pihen 3 gota çaj në ditë nga kjo bimë. Kjo bimë ndihmon edhe

im sa më të mirë të veshkave dhe sëmundjeve të tjera reumatike dhe artritin. Gjithashtu hithra mund të ndihmojë trupin në detoksifikimin e kimidorimi i kësaj bime ndihmon në pastrimin e gjakut dhe tek të sëmurët me anemi. Këshillohet që të konsumohet sa më shpesh bima e hithrës në formë sallate ose dhe e gatuar në supë ose byrek. Hithra përmban sasi të konsiderueshme të vitaminës A dhe C, vitaminë K, amin si histamina, serotoninë dhe minerale siç është hekuri shumë i rëndësishëm për organizmin e njeriut. Pra, për shkak të vlerave të shumta që ajo përmban dhe efektet e saj janë të menjëhershme. Gjithashtu, mund të pihen 3 gota çaj në ditë nga kjo bimë. Kjo bimë ndihmon edhe

në problemet që mund të shfaqen në mëlçi dhe për prodhimin e lëngut në tëmth. Për këtë qëllim mjekët rekomandojnë të pihet një gotë në ditë nga çaji i përgatitur i hithrës.



Është mirë që ai të pihet herët në mëngjes për të dhënë dhe efektin e duhur. Një ndihmesë të madhe jep hithra edhe për një funksion-

Efektet anësore të hithrës janë ende të panjohura. Por, është e dëmshme të përdoret te personat, që kanë a k u - m u l i m e

ujore si pasojë e aktivitetit të kufizuar të zemrës dhe veshkave, pasi është një çaj që nxit largimin e ujërave nga trupi.



Ornela Manjani

Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfituar nga amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku thekson se procedurat mund të

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targar

# Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

## Janë 140 mijë automjete që përfitojnë nga falja

ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/

shuarjes së detyrimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet e personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

**FSHIRJA E DETYRIMEVE**  
Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

### TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

TARGA	CD7702A	TR0049E	TR0095F	TR0148F	TR0203E	TR0249R	TR0300A	TR0342T	TR0390E	TR0439P	TR0492L
AD256	DR640A	TR004E	TR0095H	TR0148G	TR0204E	TR0249T	TR0300K	TR0344I	TR0391A	TR0439U	TR0492N
AD258	KCD4113A	TR004G	TR0095J	TR0148H	TR0204G	TR0249D	TR0301L	TR0344I	TR0391U	TR0439U	TR0492U
AD276	KTR0447R	TR0050I	TR0096K	TR0148C	TR0205	TR0250J	TR0301U	TR0346F	TR0392E	TR0441G	TR0493I
AD277	PL01A215	TR0050M	TR0096L	TR0148D	TR0205B	TR0250F	TR0301V	TR0347S	TR0392F	TR0442R	TR0493M
AD281	POLICIA222	TR0051G	TR0097L	TR0148G	TR0206I	TR0252A	TR0303A	TR0347T	TR0392L	TR0443E	TR0494G
AD300	T8635F	TR0051I	TR0097U	TR0148H	TR0206M	TR0252I	TR0303L	TR0349K	TR0392M	TR0443G	TR0494I
AD314	T9772R	TR0051L	TR0098F	TR0150R	TR0207E	TR0252P	TR0303N	TR0349S	TR0392R	TR0443J	TR0494N
AD316	T1407	TR0051M	TR0098T	TR0150T	TR0207J	TR0252P	TR0304F	TR0349T	TR0393D	TR0443M	TR0494R
AD318	TD23010	TR0052F	TR0099D	TR0152L	TR0208G	TR0253A	TR0304K	TR0350J	TR0393F	TR0445F	TR0494S
AD324	TD33003	TR0052I	TR0099I	TR0155F	TR0208L	TR0253F	TR0305I	TR0351F	TR0393M	TR0445I	TR0495L
AD341	TK70001	TR0052M	TR0099P	TR0155I	TR0208P	TR0255H	TR0305L	TR0351M	TR0394M	TR0445M	TR0495P
AD343	TR 0741 K	TR0053C	TR0099T	TR0158F	TR0209B	TR0255H	TR0306I	TR0352H	TR0394M	TR0445T	TR0495S
AD345	TR 5321 D	TR0053J	TR0099F	TR0156C	TR0209E	TR0256L	TR0306I	TR0352H	TR0395H	TR0447L	TR0496S
AD407	TR 8195 E	TR0053S	TR0100L	TR0156I	TR0210L	TR0256U	TR0306M	TR0352I	TR0395I	TR0448R	TR0498H
AD418	TR0001J	TR0054J	TR0101E	TR0157N	TR0211E	TR0257G	TR0306T	TR0352M	TR0395I	TR044CTX	TR0498I
AD437	TR0003A	TR0055E	TR0101E	TR0158F	TR0212F	TR0257R	TR0307C	TR0352S	TR0396F	TR0449A	TR0498A
AD447	TR0043F	TR0056P	TR0103M	TR0158G	TR0212K	TR0257T	TR0308	TR0353B	TR0396H	TR0449J	TR0498M
AD541	TR0004N	TR0056I	TR0103T	TR0158I	TR0212M	TR0258F	TR0308E	TR0354I	TR0396P	TR0449J	TR0498M
AD547	TR0005I	TR0056L	TR0104I	TR0158R	TR0213P	TR0258I	TR0308I	TR0354S	TR0397E	TR0451A	TR0500B
AE377	TR0005J	TR0056P	TR0104I	TR0158F	TR0213P	TR0258I	TR0308I	TR0354S	TR0397E	TR0451F	TR0500B
AC322	TR0006I	TR0056R	TR0105H	TR0159F	TR0213J	TR0258R	TR0309I	TR0355L	TR0398I	TR0451F	TR0500I
CAC969	TR0007F	TR0057I	TR0106F	TR0159N	TR0213M	TR0258H	TR0309L	TR0356J	TR0398L	TR0454M	TR0500U
CD0302A	TR0008C	TR0057L	TR0107L	TR0159P	TR0214I	TR0259I	TR0309M	TR0356L	TR0398M	TR0454S	TR0500U
CD0306A	TR0008N	TR0057M	TR0108F	TR0159G	TR0215P	TR0260J	TR0310J	TR0357F	TR0398N	TR0455L	TR0501K
CD0307D	TR0008S	TR0058M	TR0108I	TR0159H	TR0216I	TR0260M	TR0310M	TR0357F	TR0398N	TR0455L	TR0501K
CD0311A	TR0009H	TR0059K	TR0108L	TR0160D	TR0216J	TR0261F	TR0310S	TR0357J	TR0399N	TR0455L	TR0502J
CD03AB	TR0010K	TR0059M	TR0109T	TR0160E	TR0217D	TR0261H	TR0311F	TR0358G	TR0399G	TR0455L	TR0502J
CD0502A	TR0011G	TR0059U	TR0109T	TR0160E	TR0217D	TR0261H	TR0311M	TR0358G	TR0400F	TR0455L	TR0502J
CD0707A	TR0014N	TR0061F	TR0110K	TR0160F	TR0217K	TR0261I	TR0311R	TR0358H	TR0401A	TR0455L	TR0502J
CD0811A	TR0014R	TR0063F	TR0111G	TR0161F	TR0218J	TR0262N	TR0312C	TR0359C	TR0401I	TR0455L	TR0502J
CD0812A	TR0015F	TR0063I	TR0112F	TR0161P	TR0219I	TR0263F	TR0312K	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD0815A	TR0015I	TR0063T	TR0112F	TR0162A	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD0821L	TR0016J	TR0064J	TR0112R	TR0162A	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD098B	TR0015M	TR0064P	TR0113T	TR0163G	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD09A	TR0015N	TR0065H	TR0114D	TR0163N	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD1006A	TR0018I	TR0065M	TR0115L	TR0165F	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD1007L	TR0018I	TR0065M	TR0115L	TR0165F	TR0219M	TR0263L	TR0312T	TR0359C	TR0401J	TR0455L	TR0502J
CD1103A	TR0017E	TR0065S	TR0116L	TR0167H	TR0220H	TR0269J	TR0316B	TR0364M	TR0406E	TR0464F	TR0509E
CD1104A	TR0018R	TR0066D	TR0116M	TR0167K	TR0220H	TR0269J	TR0316B	TR0364M	TR0406E	TR0464F	TR0509E
CD1105A	TR0019R	TR0066F	TR0117D	TR0169I	TR0221A	TR0269U	TR0316I	TR0365J	TR0408F	TR0465D	TR0509K
CD1106A	TR0020I	TR0066P	TR0117B	TR0169I	TR0221A	TR0269U	TR0316I	TR0365J	TR0408F	TR0465D	TR0509K
CD1107A	TR0020I	TR0066P	TR0117M	TR0170M	TR0221I	TR0269U	TR0316I	TR0365J	TR0408F	TR0465D	TR0509K
CD1108A	TR0020M	TR0066S	TR0118I	TR0171F	TR0221J	TR0270X	TR0317G	TR0367M	TR0409N	TR0466G	TR0509U
CD1110A	TR0021G	TR0066F	TR0119F	TR0171G	TR0222G	TR0270J	TR0317M	TR0368P	TR0409S	TR0466G	TR0509U
CD1111N	TR0021H	TR0066I	TR0119F	TR0171G	TR0222G	TR0270J	TR0317M	TR0368P	TR0409S	TR0466G	TR0509U
CD1113A	TR0022B	TR0068L	TR0119F	TR0171J	TR0223K	TR0271P	TR0319L	TR0369G	TR0410E	TR0468L	TR0509H
CD1114A	TR0022N	TR0068R	TR0120H	TR0171R	TR0224I	TR0272F	TR0319M	TR0369H	TR0410E	TR0468L	TR0509H
CD1115A	TR0022S	TR0070F	TR0120K	TR0172F	TR0224T	TR0272N	TR0319M	TR0369H	TR0410E	TR0468L	TR0509H
CD1117A	TR0023K	TR0070G	TR0120K	TR0172F	TR0224T	TR0272N	TR0319M	TR0369H	TR0410E	TR0468L	TR0509H
CD111A	TR0023P	TR0070I	TR0121B	TR0172R	TR0225L	TR0274I	TR0320A	TR0369S	TR0410M	TR0469J	TR0510I
CD1120A	TR0024D	TR0070N	TR0121C	TR0173I	TR0226M	TR0274K	TR0320A	TR0369S	TR0410M	TR0469J	TR0510I
CD1121A	TR0024G	TR0071P	TR0123Z	TR0174A	TR0227G	TR0276G	TR0320I	TR0369E	TR0412L	TR0470L	TR0513P
CD1123A	TR0025K	TR0072P	TR0124G	TR0174G	TR0227M	TR0276G	TR0320I	TR0369E	TR0412L	TR0470L	TR0513P
CD1126A	TR0026K	TR0072J	TR0124P	TR0175I	TR0228F	TR0276M	TR0321J	TR0369G	TR0413R	TR0471J	TR0514J
CD1128A	TR0027D	TR0072L	TR0125E	TR0177E	TR0229I	TR0277G	TR0322H	TR0369H	TR0414I	TR0473M	TR0515G
CD1130A	TR0027H	TR0073E	TR0125N	TR0178F	TR0229M	TR0277H	TR0322M	TR0369H	TR0414J	TR0474E	TR0515I
CD1132G	TR0028J	TR0073G	TR0126F	TR0179F	TR0229M	TR0277H	TR0322M	TR0369H	TR0414J	TR0474E	TR0515I
CD1132A	TR0029G	TR0073L	TR0127F	TR0179H	TR0229G	TR0277H	TR0322M	TR0369H	TR0414J	TR0474E	TR0515I
CD1133A	TR0029H	TR0074E	TR0127U	TR017BTX	TR0230S	TR0278F	TR0323J	TR0369H	TR0414K	TR0474R	TR0516I
CD1134A	TR0029F	TR0075N	TR0128K	TR017G	TR0231D	TR0278I	TR0323N	TR0369H	TR0414K	TR0474R	TR0516I
CD1135A	TR0029I	TR0075R	TR0129E	TR0180J	TR0231E	TR0278P	TR0323D	TR0369H	TR0414L	TR0474U	TR0516S
CD1136A	TR0030G	TR0076L	TR0129F	TR0180J	TR0231E	TR0278P	TR0323D	TR0369H	TR0414L	TR0474U	TR0516S
CD1138A	TR0030I	TR0076R	TR0130B	TR0182J	TR0231P	TR0279U	TR0325K	TR0375C	TR0421I	TR0478I	TR0517J
CD113A	TR0031G	TR0077G	TR0131F	TR0183F	TR0232H	TR0279U	TR0325L	TR0375I	TR0423F	TR0479I	TR0517K
CD1141A	TR0031H	TR0078F	TR0131N	TR0183N	TR0232J	TR0279U	TR0325L	TR0375I	TR0423F	TR0479I	TR0517K
CD1142E	TR0032B	TR0078I	TR0132F	TR0185J	TR0233G	TR0280E	TR0326N	TR0376E	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1143A	TR0032N	TR0078K	TR0132F	TR0187E	TR0233G	TR0280E	TR0326N	TR0376E	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1145A	TR0033E	TR0078P	TR0133D	TR0187M	TR0234F	TR0280F	TR0326P	TR0376L	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1146A	TR0033I	TR0079F	TR0133H	TR0188L	TR0234G	TR0280F	TR0326P	TR0376L	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1147A	TR0034E	TR0081E	TR0133I	TR0188S	TR0234J	TR0280F	TR0326P	TR0376L	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1148A	TR0034R	TR0081J	TR0134I	TR0189E	TR0234K	TR0281L	TR0327A	TR0376M	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD114A	TR0036E	TR0082E	TR0134R	TR0189E	TR0234K	TR0281L	TR0327A	TR0376M	TR0423N	TR0479P	TR0517M
CD1154A	TR0038F	TR0082I	TR0135F	TR0190A	TR0235H	TR0282K	TR0328A	TR0377F	TR0426G	TR	

Reçenca  
e Ditës

# E vërteta për Nolin ose procesi shqip

Nga Entela Komnino

(vijon nga faqja 1)

... substancave pa kohë me emra shqip.


'Raca e shqiptarëve i ka dhënë botës tre burra, emrat e të cilëve kanë bërë epokë në historinë njerëzore. Konstandini i madh, i pari mbret i krishterë që pati kurajën të proklamojë krishterimin si një fe zyrtare në perandorinë romane ishte shqiptar. Shën Jeronimi, që përktheu Biblën dhe Ungjillin në latinishten ishte shqiptar. Heroi kombëtar i Shqipërisë Gjergj Kastrioti Skënderbeu...luftoi 25 vjet me radhë dhe e shpëtoi Evropën nga tmerrret e invazjes turke'.

u thoshte Noli shqiptarëve që kishte pranë. Çudia shqip, e bërë gati e zakonshme edhe kur një shenjt është shqiptar e përkthente Biblën dhe Ungjillin në latinisht, ka nisur, në fakt, shumë përpara edhe kohërave kur Troja prihej nga Priami, banohej nga dardanë, shkruhej nga Homeri dhe vijonte në Bothrota-Butrint nga biri i Priamit. Emra të njëjtë me ata të mbajtur si gurë kilometrikë të njerëzimit të folur, brenda pak kilometrave kultura shqipe i dëshmon ende duke treguar se shqipfolësit e kanë ditur që në krye të herës se ç'është bota.

Me pak kërkime, rrënjë e mbiemrit 'botanic' rezulton se nuk tregon në gjuhë tjetër atë që 'bota' kupton në shqip. 'Qafa e botës' është një nga rrugët që të afron në Bothrota-Butrint, e thirrur Troja e vogël nga autorët antikë. Vazhduar me 'Syrin e Kaltër' brenda ujërave e rrjedhjeve të nëndeshme të Bistricës, pranë Mesopotamisë e Finiqit nuk duket kurrfarë rrëmuje si ajo e Babilonisë. Sot për më tepër nuk duket fare që në këto vende të jetë humbur tor/ua, si për të na lënë, veç të tjerash, edhe një shenjë që mesi i fjalës retorikë -'tor', ka të bëjë me Arsyen. Edhe emri sumer i lumit Euftrat sipas leximit 'Buranun' ngacmon në shqip shkaku-'buroj' dhe kjo ndodhte afër qytetit të atëhershëm atje me emrin 'Sippar'. Aspak legjendë, por fjalë për fjalë, 'mens dhe' në indoeuropiane tregon sipas përkthimit anglisht 'to set the mind' pa nevojë të përkthet fare në shqipin 'dhe mend'!

Në fakt arsyja-ja është substanciale dhe Fan Noli e ka praktikuar në bartjen gjuhësore.

Krishti fliste me ritëm e memorije për t'u mbajtur mend nga dishepujt që e riprodhoinin përmendsh, ka treguar Noli në përkthimin e Ungjillit të Shën Mateut nga hebraishtja në anglisht me ritëm. 'Unë'-i ashtu si çdo shqipfolës në vetë të parë njëjës tregon veprimet e tij, dhe 'vers'-i (vjerëshë) si i ndryshëm, i ritmuar dhe i përkthyeshem shpjegojnë njerëzisht genien sipas shqipes në univers. Në përkthimin e Nolit që ua anglishtfolësve, fjala greke e vjetër 'ousia', e treguar me termin latin si 'substancë' e parë e universit,



nuk vendos dot lidhje tingullore edhe kur merret si 'hipostazë' apo 'person'. Sepse çdo gjë është 'arsye': si shkak i ekzistencës dhe re-

alizim i saj, si proces mendor, si rregull natyror, si marrëdhënie e mendjes me botën e jashtme, si supozim për të panjohurën dhe

rrjedhjoën, si raport me atë që na rrethon ose kemi brenda vetes, por sidomos, si proces i të qenit është edhe tingëllisht në shqip 'sy ari' i ekzistencës, i gjendur arsim, për-siatje, dhe shumë procese të tjera. Arsyje (ousia) gjendet edhe si 'Parousia' ('reason', në tregimin biblik si 'Ardhje e dytë') dhe 'Homousia' (arsyeja njerëzore) që vendosin kështu lidhje brenda vetë greqishtes së vjetër. Edhe përkthimi latinisht i 'ousia'-s në shekullin XII është 'shkak' (quidditas), por jo, siç e përmban brenda fjalës 'arsye'-ja në shqip, që ka vazhduar të gjallojë duke fjalëformuar thellë në sistem. E sidomos në ligjërimin shqip historia e gjuhës vazhdon të kërkojë ecurinë e rrënjës 'logos' dhe 'leg'. Në shqip, sipas frymës e germës, ngrihet 'ligjërim'. Një shqiptar ligjëron kur flet, pas saj ligjërohet ose përligjet për të drejtën e parqitur me ligjërim, por edhe këndon kur ligjëron si bilbil, e madje mund të qajë me ligje. Institucion i mendjes, në të njëjtën fjalë në shqip shfaqet legjislatori (përmes ligjërimit në kishë), ligji i natyrës (ligjësi) dhe natyra e ligjit (ligjet, legjislati, ligjvënës) dhe ligjërimi publik. Shqipja mban historinë e fjalës së fjalës (ligjërimit) duke treguar edhe sot përmes saj se si kategoritë e mendimit e

ekzekutimit të fjalës referojnë kapacitete mendore e komunikimi, që në gjuhë të tjera shpërndahen në fjalë e koncepte të veçanta, duke humbur gjurmën me 'logos' e 'leg'. Me këtë bartje gjuha shqipe e referon në rrënjë kapacitetin kritik të të shprehurit ose forcën e gjykimit sipas Kantit, ku fjala e parë e gjykimit 'krisis' (greqishte e vjetër) ose 'kris' në shqip, duket të ketë derivuar në 'kritik'. Një tjetër fjalë shqipe, 'radha' sfidon shpjegimin e arritur nga norvegjishtja e vjetër 'Rada' dhe sanskritishtja 'radha' për leximin anglisht 'read'. Dhe kjo sepse 'radha' e lidhur me 'këshillën' gjermanisht (Rat) meqë anglishtja quhet gjuhë gjermanike, vendos dilemën logjike nëse leximi është në radhë apo këshillë. Nga ana tjetër, 'logos' të kujton -'log', vendin ku burrat në malësitë shqiptare ku/vend/onin e fjala zinte vend për të marrë vend/ime.

Deus ose natyrë, koncepti i 'legjislatorit' - it provokon shpjegime nga shqipja për pyetjen e madhe se si është kaluar pas 'herës së parë substanciale' të ligji i natyrës dhe natyra e ligjit. Ligjërimet kishtarë deri në mes të shekullit XVII, tregojnë se kur cilësohen 'shqip' nuk kuptohet gjuha kombëtare, por oratoria, krahas leximit (letërë).

Por çfarë ka ndodhur me këtë shqipe, që si gjuhë kombëtare i mbijetoi edhe ndalimit 300 vjeçar dhe si e 'zbuloi' Noli 'shpëtimin' e saj?

Shqiptari i krishterë i Ibrik Tepesë turke, që filloi të formulonte tregimet e tij duke shpjeguar mbijetesën nga vdekje të sigurta, i ngjan më shumë se kushdo tjetër Shqipërisë në kohën e tij. Një Shqipëri e pagjetshme, përveçse në letra e botime, apo vendime për fshirjen e saj nga harta. Por në mes të kësaj 'Babilonie' sulmesh ngrihet 'Mëmëdheu... në formën e një perëndie dhe kulti i tij... në vendin e një besimi fetar'. 'Atdheu transcendent' i Mid'hat Frashërit fëmijë kur vizitonte të atin në burgjet e Konstandinopojës, është 'shpëtimi' që Noli e gjeti të nisur nga Rilindësit në procesin që e tregonte Shqipërinë si vend: përmes kohës së Skënderbeut dhe përkthimit të Frashërlinjve me 'ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë'. Ky shpëtim jo vetëm që e gjalloi fizikisht Nolin, por e formatoi për rreshta unikalë mendimi e gjuhësor. E vërteta e këtij thelbi që rri krahas gjithë substancës shqip, ka qenë e pamundur të artikulohej pa shqipen, me të cilën Noli na çudit ende. Në fund të jetës, autori shqiptar e rivendosi ndërkombëtarisht në letra këtë përshtetë retorike gjuhësore duke shënjuar Unin e Versin në thellësinë më të mundur e të mbërrihshme, që gjendet ende si 'unë' e 'vjerëshë' në shqip.

Në terma situativë, koha në të cilën Noli hyri në publicistikë, rezultoi më shumë si një kohë e treguar në përpjekjet shkrimore për të ruajtur ç'mund të ruhej, se sa funk- ➔



E vërteta ligjërimore e Nolit e vendosur mbi të vërtetën e kohës së tij, rezulton me përfundime unike mbi fakte të tilla p.sh., se si një eksperiencë e paprovueshme ëndrra e përcarti, shkruhet mes fakteve me data të jetëshkrimit të tij, që futet më tej në Historinë e Kishës shqiptare. Procesi të imagjinatës tregohen gjatë shkrimit publicistik bashkë me përvoja të paverifikueshme në një tekst të qëllimshëm si të tillë prej Nolit. Pjesë e proceseve rutinë të të mësuarit retorik, ato nuk do të ngrinin një pikëpyetje kaq të madhe, nëse në fund të jetës nuk do të gjenim se Noli kërkoi të përkthejë gjuhën e shenjtë sipas Krishtit me ritëm dhe memorje në vjershë.



← siononte mbi një vend me pushtete e sidomos teritore. Ky ka qenë, në fakt, realiteti më i madh i Shqipërisë në vitet e mjegullta për nga shteti, që e bënte publicistin 'Deus'.  
Prej këtej Noli përcolli posaçmëri themeluese të shqipes. Në fundfillim shekullin XIX-XX Shqipëria u formula si realitet mendor i paprekshëm nga asgjësimi në letrat e publicistikës e diplomacisë, atdhe i paarritshëm për kundërshtarët dhe kjo nuk ishte e rastësishme. Ekzistenca e saj varej nga materie më primare se

ato që e sulmonin. Në retorikë kjo lidhet me oponencën në ligjërimit, lirikën politike të 'genus deliberativum' e identifikuar me kapacitetin e lirisë të shqiptarët e mençur që këmbëngulën se gjuha duhet të shkruhej 'një tingul një germë'. Rilindësit shqiptarë e shkruan atdheun në letra e publicistikë duke e bërë të funksionojë deri në atë masë që më shpejt mund të bëheshe publicist shqiptar se sa shqiptar vetë. Mes tyre Fan Noli sfidoi thelbësisht përmasën e vendit e të kushteve, sipas cilësisë së shqipes për ta ruajtur faktorin shqiptar edhe pa 'Trojën', me ose pa Homer-

in e Dardanisë, por kryesisht në memorje e letra. Shqipja, e aktivizuar kështu sipas nesh, zbulon një substancë bazë mendore gjuhësore, më vepruese për gjallimin e saj dhe e paasgjësueshme, krahasuar me atë të trojeve apo administratave, e rezultuar madje e aftë të 'ristartojë' vendin. Por kjo sprovë zbulon dhe kapacitetin tjetër në rang zhvillimesh botërore: ekzistenca e një 'shqip'-eje në kufi me mendimin, e ruajtur edhe pa fjalorë e shkrime, por në fabula si ato të fillimit të botës me lëndë, dhe e një 'shqip'-eje gjuhë kombëtare, zbulon derivat më të

natyrshëm të gjuhëve në kohë e vende se sa ai i familjeve gjuhësore i mbajtur deri tani me gjuhë më të mëdha e më të vogla. Zhvlefësimi i sulmeve për asgjësimin e shqipes, tregon se bërthama e gjuhës nuk është e varur nga 'trojet', por nga kategoritë e mendimit. Trojeve të shqiptarëve u janë ndërruar emrat në historitë që të tjerët i tregojnë si të tyre e prej kësaj edhe trojet, por kapaciteti abstraktes lëndor i arsye-s ka mbetur i paprekshëm në shqip edhe si gjuhë. Në terma unikë, Troja e popullsitë, nuk mund të vlejë për 'certifikime gjuhësore prejardhjeje' për sa kohë nuk shpjegojnë dot se si gjenden përvojat kozmike në fabulat e lashtësisë, a tregimet për krijimin e botës. Klasifikimet e dëritanishme nuk shpjegojnë për të njëjtën arsye se pse nga gjuhët e një komuniteti nuk lind dot një gjuhë 'letërsie', a 'kimie', përdërisa e jetuara bashkë në kohë paska sjellë gjuhë të veçanta të bashkësive. Një sprovë e tillë e pa ndodhur tregon se gjuhët e veçanta kombëtare nuk mund të rrjedhin nga i njëjti nivel sistemi shenjash si ato vetë, vetëm për shkak të kohës ose vendit. Gjuhët kombëtare, duhet minimalisht të kenë një referencë prejardhjeje më të lartë sistemi se sa ato janë vetë, që të vendosen gjegjësisht si zhvillim në një trung prejardhjeje ose grupohen rreth një gjuhe me ngjashmëri më të madhe. Janë kapacitetet komunikative, (si retorika) ato që mund të derivojnë sisteme të nënrenditura (në këtë rast gjuhë kombëtare). 'Troja' do të ishte më pas vetëm rrethana e aktualizimit të retorikës e sistemit gjuhësor, siç tregon dhe 'udhëtimi' i emrave dhe koncepteve në kohë e hapësira të papërkrahueshme me ato mjete e zhvillim të atëhershëm, madje edhe në qiej ende të vëzhgueshëm me teleskop, madje edhe me emra të bërë simbol i udhës e endjes si Odiseu. Është aktualizimi i një sistemi të trashëgueshëm ar/sy/eje të ar/tik/ul/uar njerëzish ai që pasqyron deri kapacitetet e formulave shkencore (pavarësisht kur zbulohen këto të fundit), që nuk e bën të çuditshëm p.sh., faktin që në shqip 'lum', si uji që luan e si urim a shenjtërim me gëzim, ngjan me 'lumen' në latinisht që tregon dritën, e dikur nga lumi doli vërtetë dritë, ashtu siç në lëvizjen e parë të krijuar e përcuar për substancën, apo si në tekste operohet artistikisht 'oqeanë dritë'.

E vërteta ligjërimore e Nolit e vendosur mbi të vërtetën e kohës së tij, rezulton me përfundime unike mbi fakte të tilla p.sh., se si një eksperiencë e paprovueshme ëndrra e përcarti, shkruhet mes fakteve me data të jetëshkrimit të tij, që futet më tej në Historinë e Kishës shqiptare. Procesi të imagjinatës tregohen gjatë shkrimit publicistik bashkë me përvoja të paverifikueshme në një tekst të qëllimshëm si të tillë prej Nolit. Pjesë e proceseve rutinë të të mësuarit retorik, ato nuk do të ngrinin një pikëpyetje kaq të madhe, nëse në fund të jetës nuk do të gjenim se Noli kërkoi të përkthejë gjuhën e shenjtë sipas Krishtit me ritëm dhe memorje në vjershë.

Hetimi i ekzistencës i nisur nga vetja, vazhduar me Shqipërinë dhe përfunduar me Krishtin, i bërë një e vërtetë masive në një 'shqip'-e si të tij, duket më shumë se kurrë në kushtet e adresës numerike 'al', duke sfiduar megjithatë sipas pyetjes me habi të të gjithë jetës së Nolit për Skënderbeun '...a mund të ketë ndonjë njeri që të jetë aq i gjallë sot?'

**HOROSKOPI**

**DASHI**

Edhe reflektimet janë të dobishme, sidomos nëse nevojiten për të menaxhuar disa situata që nuk janë ashtu siç dëshironi ju. Hëna projekton të gjitha energjitë tuaja në punë, duke sugjeruar të hiqni dorë nga padurimi.

**DEMI**

Hëna ju dhuron humor të mirë dhe shpirt iniciative: pikërisht atë që keni nevojë për të përfunduar me sukses angazhimet tuaja. Marrëdhënie e shkëlqyer me partnerin: keni të njëjtat shije, ëndrra dhe reageime emocionale.

**BINJAKET**

Pak pasiguri mund t'ju largojë dhe t'ju bëjë të ndjeshëm ndaj kritikave të atyre që janë përreth jush. Mbani nën kontroll reagimet tuaja. Opinione të ndryshme në çift, megjithatë dialogu dhe konfrontimi do jenë në interes të përbashkët.

**GAFORJA**

Ditë e ëmbël, por pa rezultate. Duhet të përqipeni të mbyllni një projekt të rëndësishëm në punë pa humbur kohë. Si gjithmonë intuista juaj nuk gabon, ka ardhur momenti të rrezikoni për një çështje në biznes.

**LUANI**

Puna dhe financa janë pikat e forta të ditës. Ndjenja se mund të dominoni ngjarjet ju jep një ndjesi të fortë vetëbesimi. Një marrëveshje do mbyllet në favorin tuaj duke ju dhënë përfitime që i prisnit prej kohësh.

**VIRGJERESHA**

Pritet ndonjë grindje e vogël në çift dhe në familje, sidoqoftë asgjë nuk arrin ta ndryshojë humorin tuaj të mirë sot. Optimizmi gjithmonë ju ndihmon. Takimi më një person që keni kohë që nuk e shihni do shtojë shpresat për ata që po kërkojnë punë të re.

**PESHORJA**

Me sensin pozitiv që ju karakterizon, në punë do dëgjoni arsyetimet e të gjithëve, por nuk do hezitoni të qartësoni idetë aty ku është e nevojshme. Vazhdoni të përqendrohni në projektet tuaja afatgjata.

**AKREPI**

E hënë e shkëlqyer me mbështetjen e Jupiterit dhe Venusit në shenjin tuaj. Jeni të rrethuar nga njerëz që ju shikojnë me admirim, gjë që ju bën shumë optimist. Në aspektin e biznesit sot jeni ndjeheni me fat, ndoshta ka ardhur momenti të diskutoni rreth projekteve tuaja.

**SHIGJETARI**

Të kundërshtuar nga Hëna dhe Neptuni në kuadraturë, sot ndjeheni vetëm dhe keni shumë pak gjëra në dispozicion. Do merrni pak ndihmë nga Mercuri dhe Saturni në shenjin tuaj, të cilët të paktën ju mbajnë larg nga reziqet.

**BRICJAPI**

Do ta kuptoni që një marrëdhënie e nisur në ambientin profesional po bëhet çdo ditë më shumë intensive. Shfrytëzoni kohën e lirë dhe këtë energji pozitive që ju dhurojnë yjet për t'ju përkushtuar gjërave që ju pëlqejnë.

**UJORI**

Do jenë miqtë tuaj të ngushtë që do ju ndihmojnë edhe sot, duke ju këshilluar më të mirën për një problem personal ose një çështje financiare. Momente melankolie për diçka që e keni humbur prej kohësh tashmë.

**PESHQIT**

Çfarë dite! Do keni mbështetjen e Hënës dhe Saturnit në çështjet financiare. Realizimi i dëshirave që keni është objektiv kryesor në planet tuaja. Këshilla e yjeve është të shmangni çdo gjë të tepruar, art në të cilin jeni mjeshër të vërtetë.

BOTIMI

Shpëtim Doda

# “Flutura mes gjinjve”, paralele mes Mira Meksit e Borgesit

Tregimi në poetikën e Mira Meksit. “Flutura mes gjinjve” përmbledh tregime dhe novela pjesa më e madhe e të cilave botohet për herë të parë, ndërsa pjesa tjetër është botuar nëpër organe të ndryshme letrare, dhe është i treti vëllim i zhanrit të tregimit që Mira Meksi i sjell lexuesit të saj. Fjala është për tregime dhe novela të shkruara në kohë të ndryshme, çka tregon mjaft qartë se, ndonëse gjatë një periudhe njëzetvjeçare i është kushtuar fuqishëm romanit, Mira Meksi nuk ka hequr kurrë një herë dorë nga tregimi.

Nuk mund të ndodhte ndryshe, kujtojmë. Në rastin e poetikës së krijimit letrar të Mira Meksit, tregimi shfaqet “rrjedha” e tematikave dhe ideve që herët apo vonë përfundojnë në “detin” e romanit. Kështu, sa për të sjellë një shembull, tek *Porfida - Ballo në Versailles*, apo “*E kuqja e demave*”, ndeshemi me shtjellimin, zgjerimin dhe thellimin e jo pak tematikave dhe ideve që tek *Mali i shpirtrave* dhe “*Buzë të panjohura gruaja*” apo novela “*Ballo në Versailles*”, faksin në trajtë shkëndijimesh, përvojash, përjetimesh, ndjesish a reflektimesh në lidhje me jetën, vdekjen, kohën, hapësirën, psikën njerëzore, identitetin, tjetrin, kujtesën, harresën, traditën, erosin, dashurinë, përdytësimin, lirinë, shkrimësinë, të vërtetën, realen etj. Madje, në këtë drejtim, personazhet që mbarin dhe përcjellin thezimet ekzistenciale në fjalë, pavarësisht ndryshimit të mjedisit dhe emrit, shpalosin tipare fizike e psikike mjaft të ngjashme, mend si të bëjë fjalë për dicka të kushtëzuara e të diktuara nga vetë ideja që mbartin dhe përcjellin (krh. zonjën plakë të *Flokëkuqja e Parisit* me Doña Victoria-n e *E kuqja e demave*; përkythesen e *Mali i shpirtrave* me Porfidën e *Porfida - Ballo në Versailles* dhe me Teutën e *E kuqja e demave*; përkythesen e *Emri absolut* me dr. Aronin e *Porfida - Ballo në Versailles*). Prej këndeje, besojmë se del mjaft qartë në pah se në rastin e poetikës së Mira Meksit tregimi nuk shfaqet kurrësi një oaz shplohës së një udhëtimi të gjatë dhe të lodhshëm në detin e tallazitur të romanit; përkundrazi, krahas aspektit letrar, në poetikën e Mira Meksit tregimi kryen natyrshëm një funksion poetik të dyfishtë: 1.) funksionin *mnemotik*, duke ruajtur si nga brenda një pëstafai shkëndijimet, përvojat, përjetimet, ndjesitë dhe reflektimet e lartpërmendura; 2.) funksionin e *seminarium-it*, e fidanishtes, duke kultivuar ato ide, ndjesi, përvoja apo reflektime që herët a vonë do të tharmonjë brumin dhe atmosferat e romanit apo romaneve të mëpasme. Mjafton të sjellim si shembull tregimet “*Flutura mes gjinjve*” dhe novelën *Pa zemër në krahoror*. Pavarësisht se e shohin dritën e botimit tani, një lexues i mprehtë nuk e ka aspak të vështirë të kujtojë se koha e



shkrimit të tyre përkën me kohën e shkrimit të romanit të fundit të Mira Meksit, *Mallkimi i priftërshave të Ilirisë*; tema qendrore është e njëjtë, dashuria njerëzore dhe misioni i epërm: Jorikoja kërkon sublimimin e poezisë së saj, piktorja e re sublimimin e dashurisë së vërtetë, ndërsa Teuta të prirë Ilirinë nëpërmjet çlirimit të hyjnore që gjallon brenda saj së bashku me njerëzoren. Edhe fundi i tyre është i njëjtë: të treja kanë një përfundim tragjik, ia blatojnë jetën dhe dashurinë trupore përmbushjes së misionit të tyre përkatës; madje Joriko dhe Teuta përmes të njëjtit mekanizëm: vetvrasjes.

Julio Cortázar-i, mjeshtër i madh i tregimit, pohonte vazhdimisht se tregimet i shkruante në një gjendje *delirium-i* të qashtë: gjurmët e kësaj gjendjeje i ndeshim vazhdimisht, në trajtë vegimesh apo feksjesh (“rastësi” apo “aksidenti”, i emërtun Meksi), jo vetëm tek tregimet e këtij vëllimi, si *Buzëqeshja e fundit* e *Beatrices*, *Pa zemër në krahoror*, *La gringa*, *Befasi*, *Paqyrat e Bledës*, *Drakula në labirintin e tij*, por edhe tek tregimet e mëparshme të Mira Meksit, si *Mali i shpirtrave*, *Aksidenti*, *Emri absolut*, *Flokëku-*

*qja e Parisit* etj. I parë nga ky drejtim, në funksionin e tij prej *seminarium-i*, për Mira Meksit tregimi është hapësira e kultivimit poetik të elementit fantastik dhe neofantastik që ndeshim mjaft shpesh e dendur në thuasje tërë veprën e saj letrare, duke e përgjeshtruar paq pohimin e Tzvetan Todorov-it tek *Letërsia fantastike*, sipas të cilit “psikanaliza e ka zëvendësuar (dhe, për rrjedhojë, e ka bërë të pavlerë) letërsinë fantastike”.

Duke mos qenë realitet paralel, apo botë paralele, e vetmja ligjësi që hasim mbizotëuese tek tregimet e Mira Meksit, është “rastësia”, “befasia”, “aksidenti” (krh. *Befasi*, *Dashuri e fajshme*, *Verë në Firence*, *La gringa*, *Dashnorët e Venedikut* etj); tek e fundit, gjithë sa i shpëton rregullit, kanonit, ligjeve. Për rrjedhojë, ndryshe sa vërejmë tek Borges-i dhe Cortázar-i, tek Mira Meksi elementi fantastik nuk e prek as formën, as ontologjinë e reales, por rendin dhe, mbi të gjitha, kuptimësinë e saj, në stofin e së cilës shpërfaqet si një gjurmë, duke u shpalosur si formë hapjeje drejt realiteteve (viz. shprehjeve të reales) të reja, para të cilave realiteti i përditshëm vi-

## Tregimet që shërbyen si bërthama romanesh

jon të ruajë gjithësi një natyrë dhe përmasë qartësisht të dallueshme.

Krahas sa më sipër, tek këto tregimet dhe novela të Mira Meksit spikat një tjetër element që meriton të sillen në vëmendje; shprehimisht, faktin që, krejt ndryshe nga Harold Bloom-i, Mira Meksi nuk e përdeton “të qenit e ndikuar” nga të mëdhenjtë e letrave si “makth”, por si diçka e pashmangshme, si diçka e domosdoshme dhe, mbi të gjitha, si një “bekim” të vlefshëm që e shpall haptazi, madje si një stafetë, qoftë tek përvetësimi i modelit të tregimit analitiko-hulumtues të lëvruar nga Borges-i, - çka përbën një risi në tregimin shqip, - qoftë përmes elementëve të larmishëm të ndërtekstosorisë, të pranishëm deri dhe tek titujt, siç shfaqet rasti i *Pierre Menard-i i dytë autori i Kishotit* dhe i *Buzëqeshja e fundit* e *Beatrices*, të përvetësuar nga Borges-i, apo rasti i *Dashnorët e Venedikut*, i përvetësuar nga Charles Maurras, pa anashkaluar edhe rastet kur elementët në fjalë jepen në trajtë *exergum-i* (krh. *Verë në Firence*, *Pierre Menard-i i dytë autori i Kishotit*, *Dashuri e fajshme*, *Drakula në labirintin e tij* etj), të cilat synojnë që të orientojnë qoftë rrëfimin, qoftë leximin.

E megjithatë, kjo pikë gjykojmë se ka nevojë për një dritëdhedje sado të shkurtër. Më lart u shprehëm për “ndikimin”, i cili nuk është kurrësi i barazvlefshëm me “plagiaturën”, dhe aq më pak me “kopjimin”. Përkundrazi, parë në këtë drejtim, mes Mira Meksit dhe Borges-it, i cili jo vetëm përmendet dendurazi (krh. *Dashuri e fajshme*, *Drakula në labirintin e tij*, *The unending gift*, *Pasqyrat e Bledës*), por jepet edhe si personazh në tregim (krh. *Buzëqeshja e fundit* e *Beatrices*, tek ky vëllim, apo *Aksidenti*, tek *Buzë të panjohura gruaja*), ekzistojnë jo pak dalime, madje edhe kundërti, qoftë edhe në ato raste kur tematika e tregimit është dukshëm, madje edhe shprehimisht, borgesiane, çka për Borges-in është e vetëkuptueshme, për aq sa është i vetëdijshëm se “është Odisea, e cila ndryshon sipas detit” (krh. *Nubes*), se është tematika, e cila ndryshon sipas kontekstit dhe qasjes interpretative (krh. *Pierre Menard autor del Quijote*), jo e anasjellta.

Këto rreshta nuk synojnë aspak të jenë një diktat, mënyrë apo receptë leximi e tregimeve të Mira Meksit, por një ftesë drejtuar lex-

uesit për të përjetuar leximtarisht dhe *ad personam* goftë gjendjen e *delirium-it* të krijimit të saj artistik, feksjens e idesë, udhëtimin nëpër një mori kohësh e vendesh të njohura dhe të panjohura, reale dhe irrealë, psikike dhe fizike, goftë për të shijuar frytet e një “ndikimi” të perceptuar, përjetuar dhe shpallur si “bekim”. Porse, për të mos e lënë të shfaqet një pohim jetim, në këtë hapësirë mund të mjaftohemi të sjellim në vëmendje, telegrafikisht, disa dalime që vërejmë mes Mira Meksit dhe Jorge L. Borges-it. Kështu, për Borges-in, i ndikuar nga budizmi, njeriu i përshtatet fatfundësisë, një fryt i “përpërsësisë së llojit dhe hiçësisë pothuajse të përsosur të individi” (*Historia de la eternidad*), ndërkohë që tek tregimet e Mira Meksit njeriu nuk i përshtatet, por e krijon vetë fatfundësinë e tij (i vetmi përjashtim shfaqet *Dashuri e fajshme*); dhe teksa e krijon, ai ndërton hallkë pas hallke njerëzoren brenda tij, kryen shkëputjen nga bota e gjallesha dhe lartohet ontologjikisht, si të thuash, dhe jo siç ndodh tek Borges-i, i cili në një mënyrë të përvetësuar nga Borges-i, apo rasti i *Dashnorët e Venedikut*, i përvetësuar nga Charles Maurras, pa anashkaluar edhe rastet kur elementët në fjalë jepen në trajtë *exergum-i* (krh. *Verë në Firence*, *Pierre Menard-i i dytë autori i Kishotit*, *Dashuri e fajshme*, *Drakula në labirintin e tij* etj), të cilat synojnë që të orientojnë qoftë rrëfimin, qoftë leximin.

Sakaq, ndërsa te Borges-i ndeshet vazhdimisht motivi i harresës frymëqeruese që lindin nga frigimi i përdytësimit (*El despartar*), ai i *ëndërrës së jetuar nga askushi*, i hiçësisë së përjetshme *alla Schopenhauer*, shkëlqimi i errët i të cilit i shfaqet shumë më tepër i pranueshëm sesa shfaqen vetë gjithësia, historia dhe garkesa e papërbalueshme e Kujtesës, për Mira Meksit vlen e kundërt: Kujtesa, dhe vetëm Kujtesa shfaqet si frymëqeruese, vetëm ajo mund të kthehet në proces katarsik. Për këtë arsye, të tërë personazhet e Mira Meksit ngarendin vazhdimisht dhe me këmbëngulje të “kujtojnë”, të “rëbëmojnë” (krh. *Flokëkuqja e Parisit*), apo “të gjejnë strehë” tek Kujtesa (krh. *Befasi*), madje, kjo mund të thuhet edhe për ato raste kur “harresa” është terapia më e mirë, një mekanizëm psikologjik që rreh të zhvendosë caste apo ngjarje të cilat shndërrohen vetvetishëm në burim dhembjeje për individin, siç ka treguar më se një herë Freud-i, dhe siç shfaqet rasti i Violës tek *Flutura mes gjinjve*.



## Katovica

## Shqipëria të bllokojë Serbinë në “Frankofoni”

Nga SHABAN MURATI

(vijon nga faqja 1)

... të tjera se Kosova është çështje e pandarë e kombit shqiptar, pra edhe e interesit jetik të Shqipërisë. Kjo dobësi konsiston në faktin që kërkesat tona për njohjen e Kosovës nuk janë shoqëruar me vepra dhe me veprime, që ndikojnë në dinamikën diplomatike me shtetet e tjera. Duke mos qenë koha të rendim nëpër faqet e historisë së diplomacisë shqiptare të periudhës postkomuniste për të parë çfarë është bërë keq, po ndalemi në raportet me Serbinë dhe më konkretisht në një rast të ditëve të fundit, për të kuptuar si duhet bërë mirë. Në datën 8 nëntor zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, njoftoi në një konferencë në MPJ: “Unë dua të shpreh gatishmërinë e Republikës së Serbisë për të filluar së shpejti procedurën për të marrë statusin e anëtarit të plotë të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë”.

Një diplomaci e kujdesshme shqiptare nuk mund ta neglizhojë këtë sinjal dhe pikërisht për këtë unë po tërheq vëmendjen. Është një rast i artë që Shqipëria të demonstrojë me vepra përballë Serbisë se kërkesën për njohjen e Kosovës Tirana nuk e ka thjesht retorikë diplomatike.

Shqipëria është që nga viti 1999 anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, ONF. Në statutin e kësaj organizate thuhet tekstualisht se “shtetet që duan të bëhen anëtare të ONF duhet të bëjnë kërkesë zyrtare. Është samiti i Frankofonisë që mbi bazën e rekomandimit të konferencës së ministrave vendos nëse duhet pranuar ose jo aplikanti i ri. Ky vendim duhet të merret në mënyrë unanime”. Kjo do të thotë që Shqipëria ka të drejtën e vetos si të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë për të pranuar ose jo një anëtar të ri. Praktika diplomatike, logjika dhe interesi ynë sugjerojnë që Shqipëria nuk mund të mos e vlerësojë këtë rast për ta përdorur të drejtën e vetos në dobi të sanksionimit të njohjes ndërkombëtare të Kosovës, dhe më konkretisht nga Serbia. Kjo do të thotë që Shqipëria nuk mund t'i lejojë vetes ta anashkalojë këtë rast të përshatshëm diplomatik pa kërkuar asgjë nga aplikanti i ri, Serbia. Shqipëria nuk mund të vazhdojë më praktikën e mëparshme të gabuara, që ka ndjekur në të kaluarën, kur pa u kërkuar asgjë për Kosovën, lejoi Rusinë të bëhej shtet vëzhgues në Konferencën e Bashkëpunimit Islamik dhe lejoi Moldavinë të futej në organizatën rajonale të Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Europës Juglindore, SEEC.

Shqipëria duhet të përdorë të drejtën e vetos për të mos lejuar që Serbia të pranohet në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë pa bërë kompromiset e duhura për Kosovën. Përsa Shqipëria duhet ta ndërmarrë këtë hap?

Së pari, sepse Shqipëria ka për detyrë që t'i tregojë Serbisë që marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Serbisë dhe bashkëpunimi i tyre në organizatat dhe në forumet ndërkombëtare e rajonale nuk mund të jetë i plotë dhe as reciprok nëse Serbia nuk merr në konsideratë kërkesat shqiptare për njohjen e Kosovës dhe vazhdon bllokimin e saj në organizimet

Shqipëria në veprimtarinë e saj ndërkombëtare duhet t'i bëjë të qartë Serbisë, Ruisë dhe të tjerëve, se nuk mund të avancohen marrëdhëniet me Shqipërinë nëse ato dëmtojnë interesat jetike të Shqipërisë, ndër të cilat është edhe Kosova



ndërkombëtare.

Së dyti, Shqipëria duhet të përdorë të drejtën e vetos së saj për anëtarësimin e Serbisë në ONF, sepse kështu pastron rrugën e Kosovës për anëtarësim në ONF. Kosova është pranuar si shtet me statusin

e vëzhguesit në ONF në nëntor të vitit 2014. Por nëse Shqipëria do të lejojë që Serbia të anëtarësohet në ONF përpara Kosovës, kjo do të krijojë situatën që Serbia të bllokojë dhe të mos lejojë Kosovën të bëhet anëtare e kësaj organizate. Pra, Serbia do të përsërisë bllokadën, që po bën

Shqipëria të përdorë të drejtën e vetos për anëtarësimin e Serbisë në Frankofoni si një mundësi e re për mbrojtjen e interesave të Kosovës, të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar.

për Kosovën në UNESCO. Shqipëria mund ta lejojë anëtarësimin e Serbisë në ONF duke i vënë kushtin që Serbia të mos pengojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë. Dhe kjo nuk realizohet me premtime boshe nëpër tavolina koktejesh, por bëhet me marrëveshje të shkruara ose me shkëmbime notash zyrtare midis Shqipërisë dhe Serbisë.

Së treti, ka ardhur dhe madje ka kaluar koha që Shqipëria duhet të reagojë edhe në rrugë diplomatike, edhe në rrugë publike, ndaj fenomenit të shëmtuar të

bllokimit dhe të pengesave, që Serbia po i bën pranimit të Kosovës në organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Serbisë i duhet bërë e qartë se kjo politikë obstruksioniste e saj ka pasojë dhe efektë dhe konsiderohet armiqësore jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe ndaj Shqipërisë. Tirana duhet të jetë e para që duhet t'ia vizatojë këtë vijë të kuqe Serbisë. Shqipëria duhet të reagojë ndaj veprimtarisë negative të Serbisë në organizatat dhe në forumet ndërkombëtare, që pengon Kosovën të anëtarësohet në to. Nëse Tirana nuk reagon për bllokimin që Serbia po i bën Kosovës në UNESCO apo në Interpol apo në organizatat të tjera ndërkombëtare, kjo interpretohet në Beograd jo vetëm si dobësi e Shqipërisë, por edhe si provë që Shqipëria nuk e konsideron Kosovën pjesë të çështjes së saj kombëtare. Nuk mendoj se flet në favor të heshtjes së Shqipërisë fakti që Serbia ka nënshkruar në prill të vitit 2013 marrëveshjen me Kosovën për normalizimin e marrëdhënieve dhe për mospëngimin e integritimit evropian të Kosovës në BE dhe nga ana tjetër zhvilloj një veprimtari intensive, madje historike, kundër njohjeve të Kosovës dhe kundër pranimit të saj në organizatat ndërkombëtare. Në datën 9 nëntor ministri i Jashtëm serb Dačić, me mburavëcinë tipike rurale ballkanike, u lavdërua se vendimi i Prishtinës për të shtyrë aplikimin për pranimin e Kosovës në UNESCO ishte një fitore e madhe e Serbisë dhe se me këtë rast “Ne mundëm SHBA, Britaninë, Francën, Gjermaninë, Turqinë, Arabinë Saudite”. Ministri i Jashtëm serb nuk e përmendi fare Shqipërinë. Shqipëria e ka për detyrë t'i kujtojë Serbisë se kështu nuk mund të vazhdohet dhe se Serbia duhet të respektojë marrëveshjet dhe normat e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit rajonal.

Së katërti, sanksionimi i statusit ndërkombëtar të Kosovës si shtet i paruarur me të drejtë të plota të anëtarësimin në OKB dhe në gjithë organizatat ndërkombëtare është pjesë e çështjes jetike kombëtare të kombit shqiptar dhe si e tillë është prioritet i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i diplomacisë së saj. Kjo do të thotë që Shqipëria në veprimtarinë e saj ndërkombëtare duhet t'i bëjë të qartë Serbisë, Ruisë dhe të tjerëve, se nuk mund të avancohen marrëdhëniet me Shqipërinë nëse ato dëmtojnë interesat jetike të Shqipërisë, ndër të cilat është edhe Kosova. Shqipëria duhet të marrë pak shembull nga përvoja e diplomacisë greke, e cila që prej 25 vitesh po u bën rreshtore diplomacisë, qeverive dhe shtetit shqiptar për minoritetin grek.

Është koha që Shqipëria të jetë më agresive dhe më e guximshme në mbrojtjen e interesave të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe rajonale. Miqtë dhe jomiqitë në arenën ndërkombëtare të vlerësojnë dhe të marrin në konsideratë kur i ngre hapur dhe me forcë problemet dhe interesat shtetërore e kombëtare dhe jo kur hesht për to. Ndaj sugjerimi im për qeverinë e Shqipërisë është që të përdorë të drejtën e vetos për anëtarësimin e Serbisë në Frankofoni, si një mundësi e re për mbrojtjen e interesave të Kosovës, të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar.

Rumuni u beson lojtarëve të rinj

Mircea Luçesku kërkon fitoren ndaj Shqipërisë



Trajneri i Turqisë, Mircea Luçesku, ka folur shumë gjatë në konferencën tradicionale për shtyp para ndeshjes me Shqipërinë, duke iu referuar fillimisht kohës që kur ka marrë drejtimin e saj. Trajneri rumun, në fakt, ka pak kohë të Turqia, por po e sheh se i rrezikohet seriozisht vendi i punës për shkak të rezultateve jo të

mira. "Kam kaluar një kohë të suksesshme te Gallatasaray dhe Beshiktashi. Nuk kam pasur shumë kohë për t'u njohur me skuadrën, kam ardhur vetëm pak para ndeshjes me Ukrainën. Ndaj Rumanisë dhe Shqipërisë kam zgjedhur për të provuar

lojtarë të rinj. Vetëm ndaj Rumanisë ishin 3 debutues në fushë. Për sa i përket Emre Morit, i kam thënë se duhet të luajë më shumë me ekipin e tij. Kombëtarja turke ka talente". Ndërkohë, trajneri rumun i Turqisë shpreson që lojtarët vendës

të arrijnë të transferohen në kampionate elitare, njëjtë siç po bëjnë lojtarët shqiptarë, që po shkëlqejnë në Itali. "Ndeshe mi Shqipërinë dhe shumë prej lojtarëve të saj luajnë në Itali. Pasi të arrijnë nivelin e duhur, edhe lojtarët turq

duhet të largohen kështu. Ata luajnë të gjithë në ekipet e tyre, edhe lojtarët tanë duhet të aktivizohen rregullisht me klubet e tyre. Besoj se kemi një kombëtare me nivel, por më duhet edhe ndihma juaj për të pasur sukses". Mircea Luçesku e ka drejtuar përfaqësuesen turke në 5 takime zyrtare, ku ka fituar vetëm një takim, atë ndaj Kroacisë.

Italiani i stolit kuqezi beson se ndaj Turqisë, Shqipëria do të arrijë një rezultat pozitiv

Panuçi e ka me lojtarët: Të na tregonin për dëmtimet

Mbron Alijin: E mora, sepse jemi një familje



Jeton Selimi

Kristian Panuçi ka besim se Shqipëria do të bëjë një paraqitje të mirë në miqësoren e kësaj të hëne ndaj Turqisë në Antalya. Në konferencën për shtyp përpara kësaj sfide trajneri italian i kuqezinjve u shfaq i kënaqur me formën dhe impenjim që kanë treguar futbollistët gjatë kësaj jave në stërvitje. "Kemi punuar mirë gjatë kësaj periudhe. Këto kanë qenë ditë intensive për ekipin. Kemi punuar në të gjitha aspektet, dhe jam i kënaqur me atë që djemt kanë treguar në stërvitje, duke ditur se kjo është një periudhë e ngjeshur edhe me klubet e tyre. Dua të falënderoj futbollistët e mi të cilët janë treguar shumë profesionistë, kanë punuar me seriozitet të plotë dhe janë stërvitur mirë edhe pse bëhet fjalë vetëm për një ndeshje miqësore." Strakosha, Basha dhe Latifi u larguan të dëmtuar nga grumbullimi i Kombëtares, por Panuçi e ka një



përgjigje edhe për këtë. "Duhet të jemi profesionistë.

Lojtarët e dëmtuar duhet të sjellin një rezonancë apo një

EKO me vete. Mjeku i ekipit Kombëtar duhet ta vlerësojë nëse është i gatshëm për lojë apo jo. Federata në këtë rast ka vepruar në mënyrë profesionale. Strakosha ishte rast i veçantë, pasi këtë të enjte iu shfaqën probleme të vjetra të dëmtimit. Ndërsa kur

pyesja Latifin, më përgjigje se ishte mirë. Për Bashën kemi telefonuar stafin mjekësor të Barit, por askush nuk na është përgjigjur". Edhe pse është pa skuadër tek aktualisht stërvitet me Bazelin, Panuçi ka grumbulluar për miqësoren ndaj Turqisë Naser Alijin, futbollist të cilin trajneri e vlerëson shumë, madje kur pyetet për të është i gatshëm të përdorë edhe tonet e ashpër në drejtim të gazetarëve. "Këtu po flisni për Alijin. Para se të jemi skuadër, jemi familje, dhe duhet të mbështesim lojtarët edhe në ditët e tyre të vështira. Aliji është një lojtar i nivelit evropian dhe ka qenë edhe më parë pjesë e grupit. Gjatë javës ka punuar shumë, edhe pse nuk është i gatshëm për 90 minuta lojë."

KAPITENI KUQEZI



Berisha: Për ne, Euro 2020 fillon ndaj Turqisë

Bashkë me trajnerin Panuçi, në vigili të miqësore me Turqinë, në konferencën për shtyp ishte edhe portieri Etrit Berisha. Gardiani i portës iu përgjigj pyetjeve në lidhje me atmosferën në grup, si dhe për ndeshjen e nesërme. "Jemi të kënaqur me punën që kemi bërë këtë javë në përgatitjet për ndeshjen me Turqinë. Prurjet e reja kanë sjellë freski në ekipin kombëtar. Kemi punuar shumë në të gjitha mënyrat. Për ne, kualifikimet për në Europianin 2020 fillojnë që nesër (sot), dhe duam ta përfaqësojmë sa më mirë, që të fitojmë besimin për në të ardhmen. Kam parë që përfaqësuesja turke ka disa emra të rinj, kanë kualitet. Edhe ata janë në një fazë tranzicioni, por për ne është e rëndësishme që të përfaqësohemi sa më mirë, e gjithë skuadra. Nuk kam frikë ndonjë lojtar specific, ne do fokusohe mi tek loja jonë."

Lojtarët flasin për miqësoren

Lilaj e Veseli: Duam fitoren ndaj Turqisë



tonë. Do të kërkojmë të paraqitemi mirë dhe pse jo të marrim edhe rezultat pozitiv në këtë sfidë. Nuk e kisha takuar asnjëherë Panuçin, por kjo nuk është e rëndësishme, sepse në kombëtare vlen vetëm paraqitja dhe forma e mirë për t'u aktivizuar". Ndërkohë, ndeshjen me Turqinë, mbrojtësi Frederik Veseli nuk e konsideron aspak një miqësore. Gjithashtu, ai ka treguar se ka pasur oferta nga Serbia A, por nuk lëvizti, presidenti i skuadrës italiane ka vënë "veton". "Nuk ekzistojnë ndeshjet miqësore.

Edhe ndaj Turqisë do të kërkojmë të japim maksimumin dhe të paraqitemi mirë. Kemi pasur një javë kohë për ta përgatitur këtë sfidë dhe mendoj se kemi punuar mirë, jemi bashkuar edhe më tepër si grup dhe kemi pasur mundësi të njohim më mirë edhe trajnerin. Jam në formë të mirë dhe kam qenë në fushë rregullisht. Jam munduar të jap më të mirën dhe besoj se po ecim mirë. Kemi marrë edhe disa rezultate negative, por do të tentojmë deri në fund shanset për t'u ngjitur në Serinë A. Është e vërtetë që kam pasur oferta nga klube të Serisë A, në merkaton e verës, por presidenti i Empolit nuk më la të largohem, duke më rinovuar edhe kontratën. Tani jam i përqendruar të jap maksimumin, për t'u ngjitur në Serinë A, bashkë me Empolin".

LEGJENDA E PORTËS RREZIKON BOTËTORIN E PESTË


Xhixhi Bufon: Jam shumë i tensionuar

Nesër do të luhet sfida më e rëndësishme sa i përket "play off"-it për Botërorin e Rusisë, ajo midis Italisë dhe Suedisë. Kjo ndeshje merr një rëndësi të dyfishtë, teksa shohim rezultatit e ndeshjes së parë, atje ku Suedia fitoi 1-0 përballë kombëtares italiane. Gjithsesi, një eliminim në ditën e nesërme përveçse një zhgënjim i madh tek tifozët dhe një njollë në historinë e Italisë, do të ishte mbyllja me e keqe e karrierës për Bufonin. Këtë e di më së miri dhe vet legjenda italiane, i cili në konferencën për shtyp për mediat lokale është dukur paksa i tensionuar. "Unë jam i tensionuar, por ky është një tension i drejtë. Kemi nevojë për mbështetje. E jetoj këtë ditë si një vigili në prag të një ngjarje të rëndësishme. Jam i fokusuar për sfidën ndaj Suedisë. Brenda apo jashtë botërorit, kjo nuk do të ndryshojë asgjë nga vendimet e mia për të ardhmen. Situata ime kalon në plan të dytë përpara skuadrës", -tha Bufon.





**Fjalëkryqi (1)**



- 37. Janë baballarët.
- 38. Fillojnë titrat.
- 39. Ai dhe ajo.
- 40. Mbledh basketë separatistë.
- 41. Fillojnë saldimin.
- 42. Gjysma e krahut.
- 45. Në krye të armatës.
- 46. Gjysmë krisme.
- 47. Jepet për hartim.

- VERTIKAL**
- 1. Paul që qe poet i famshëm.
  - 2. Dennis i McLaren.
  - 3. Këndohet në opera.
  - 4. Gjysmë siklet.
  - 5. Kufijtë e matjes.
  - 6. I zhvillon kongresi.
  - 7. Inicialet e Moravia-s
  - 8. Janë krerë bandash.
  - 9. Të fundit në tender.

- HORIZONTAL**
- 1. Humanisti i Rotterdemit
  - 6. Mund të jenë cigaresh.
  - 12. Capirossi i MotoGP.
  - 13. Eshhtë bixhoz
  - 14. I vetmi në orar.
  - 15. Para Diego në Kaliforni.
  - 16. Fillojnë sefte.
  - 17. Eshhtë makina për guidë.
  - 21. Inicialet e Benigni-t.
  - 23. Janë riparime.
  - 25. Janë të brishtë.
  - 27. Fillojnë largimin.
  - 28. Ishin kambistë të dikurshëm.
  - 29. Një motoskaft gare.
  - 31. Kështu thirrej Marco Pantani.
  - 32. Janë penjtë për moline.
  - 33. Emër vajze.
  - 35. Janë edhe ato të cirkut.
  - 36. Nuk ka tradhtari.


- 10. Fund shkurti.
- 11. Mund të jenë grosistë
- 13. Ka shirit magnetik një e tillë.
- 15. Ishin engjëj të korit të lartë
- 17. Janë gjynahet
- 18. Bega komik.
- 19. Janë shemra.
- 20. Inicialet e Morricone-s.
- 22. Janë edhe ato fetare.
- 23. Një gjuajtës francez.
- 24. Gjika e Dora D'Istria-s.
- 26. Qytet grek.
- 29. Bëjnë katrorë me një kat.
- 30. Ishin ndjekësit e Antistenit.
- 32. Shkruhet i treti.
- 34. Një sulm... kardiak.
- 36. Ki Moon i OKB
- 40. Inicialet e Rohmer.
- 43. Robert Mitchum.
- 44. Dy asa.

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL**
- 1. Bëhet një me psonisje.
  - 5. Një mund të jetë qeveritar
  - 11. Maiden që këndojnë.
  - 13. Një ushtarak është solemn.
  - 15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
  - 16. Tëket pa kufij.
  - 18. Mbetet në fund.
  - 19. Një treshe në skenë.
  - 21. Një mongol i Timurlengut
  - 23. Një peshk i rëndë.
  - 25. Triac ish-tenist
  - 26. Kufizojnë një takim.
  - 27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
  - 30. Fillojnë nazet
  - 31. Kalimi në krye.
  - 32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
  - 34. Janë portet.
  - 35. Dashi kur mungon ai
  - 37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
  - 38. Kufizohet në kufij
  - 39. Ente Civile Europeane.


- 40. Një birrë.
- 41. Mbetur në fund.
- 42. Ramazotti këngëtar
- 43. Janë në modë.
- 44. Janë tek në shaka.
- 45. Eshhtë dite në mbledhje.
- 47. Një pjesë e kandidaturave.
- 49. Jessica Parker aktore.
- 50. Inicialet e Presley.
- 51. Akoma është ndryshe.
- 52. Janë bërjntë në skuadër.
- 53. Qendër fitimi

- VERTIKAL**
- 1. Brad aktor.
  - 2. Komandohet nga gjenerali.
  - 3. Në hyrje të zonës
  - 4. Janë në skaje
  - 6. Janë librat e parë
  - 7. Mund të jetë arme.
  - 8. Inicialet e Turgeniev.
  - 9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.




- 10. Mund të lakohet.
- 12. Janë araknidet si vejsua e zezë.
- 14. Mund të jetë e lirë në port.
- 17. Një mjet lundimi.
- 20. Shkroi Rinoceronti.
- 22. Ekstre në ritëm.
- 24. Kalohen në gjumë.
- 28. Filmi i parë shqiptar.
- 29. Fillojnë takimet
- 31. Kufizojnë kënde.
- 32. Një depozitë drithi.
- 33. Janë vendet e para.
- 34. Një parabolë e tenistit.
- 36. Eshhtë llogari që qerohet.
- 37. Shteti me Khartum.
- 38. Janë kapot e bandave.
- 40. Një thirrje e dëshpëruar nga direku.
- 41. Lohim brigje.
- 42. Një idrëz.
- 46. King Cole i muzikës.
- 48. Fillojnë ndeshjen.
- 49. Sapo fillojnë.
- 50. Mbetet në fund.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik

*Argëtim filozofik*

- "Kij parasysch se vetëm ai që lufton me errësirën brenda tij, do të ketë nesër e pasnesër një pjesë të tij tek Dielli!"

Odisea Eliti

- 'Mos shkatërro atë që ke, duke dashur me epshtë që nuk ke. Mbaj mend se ajo që tani ke, dikur ishte gjëja e parë e atyre që dëshiroje të kishe'.

Epikuri



*Thënie të mençura*

- Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty ku pak kanë qënë.
  - Përgjuesi është i ngjashëm me atë që hedh pluhur kundër dikujt tjetër kur era është në drejtim të tij ; kështu pluhuri s'bën gjë tjetër veçse i kthehet atij që e hodhi.
  - Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh.
- (Anonim)

**SUDOKU**

			4	3	6				
3	7		1		9		2	4	
9				2				6	
	6						3		
1								8	
	9						4		
8				4				1	
7	4		8		1		9	5	
			7	5	2				


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	5	4	2	3	7	9	1	8	
7	3	1	5	9	8	2	6	4	
2	8	9	1	4	6	3	7	5	
3	7	8	6	5	9	1	4	2	
1	9	5	4	7	2	8	3	6	
4	2	6	3	8	1	7	5	9	
8	6	3	7	2	4	5	9	1	
5	4	2	9	1	3	6	8	7	
9	1	7	8	6	5	4	2	3	

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



- Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty ku pak kanë qënë.
  - Përgjuesi është i ngjashëm me atë që hedh pluhur kundër dikujt tjetër kur era është në drejtim të tij ; kështu pluhuri s'bën gjë tjetër veçse i kthehet atij që e hodhi.
  - Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh.
- (Anonim)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

